

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE– CIKLI I DYTË

Teza:

Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm, aspekte rajonale ballkanike.

Kandidati:

Shkëlqim Veseli

Mentor:

prof.dr.Besa Arifi

Tetovë, 2018

Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia e hulumtimit	5
I. Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm.....	6
1.1. Vështrim historik.....	6
1.2. Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm	8
1.3. Llojet e ekstremizmit të dhunshëm	9
1.4. Lidhshmëria e ekstremizmit të dhunshëm me terrorizmin.....	11
II. Fenomeni i ekstremizmi të dhunshëm.....	13
2.1. Ekstremizmi i dhunshëm, sfidë e botës bashkëkohore.....	13
2.2. Disa veçori të ekstremizmit të dhunshëm	14
2.3. Zonat në të cilat është më i përhapur fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm	15
2.4. Mosha dhe gjinia e personave të radikalizuar	17
2.5. Gjendja martesore dhe statusi familjar.....	19
2.6. Gjendja sociale- statusi social	19
2.7. Të dhëna themelore për organizatën më ekstreme në botë, ISIS	20
III. Shkaqet e ekstremizmit të dhunshëm.....	23
3.1. Ideologjia shkak i ekstremizmit të dhunshëm.....	23
3.2. Problemet ekonomike dhe ekstremizmi i dhunshëm.....	26
3.3. Lufta dhe ndikimi i saj në ekstremizmin e dhunshëm.....	28
3.4. Burgu „vatër” e ekstremizmit të individëve.....	29
3.5. Roli i mediave dhe ndikimi i tyre në ekstremizmin e dhunshëm	31
3.6. Shkalla e edukimit dhe arsimimit në raport me ekstremizmin e dhunshëm.....	33
3.7. Familja dhe rrethi shoqëror në raport me ekstremizmin e dhunshëm	35
IV. Viktimat e ekstremizmit të dhunshëm	38
4.1. Viktimizimi nga ekstremizmi i dhunshëm, në përgjithësi.....	38
4.2. Klasifikimi i viktimave të ekstremizmit të dhunshëm	40
V. Mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.....	42
5.1. Mekanizmat të cilat i ka paraparë Republika e Maqedonisë.....	42
5.2. Mekanizmat të cilat i ka paraparë Bashkësia fetare islame e Maqedonisë	46
5.2.1. Intervista me prof.dr. Musa Musai	48

5.3. Organizatat joqeveritare, kontributi i tyre në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm	55
VI.Disa shtete të Ballkanit në raport me dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm dhe rastet në praktik	56
6.1. Republika e Maqedonisë, raste në praktik të ekstremizmit të dhunshëm	56
6.2. Republika e Shqipërisë dhe ekstremizmi i dhunshëm.....	60
6.3. Republika e Kosovës dhe ekstremizmi i dhunshëm.....	61
Përfundim.....	63
Lista e shkurtesave	64
Biblografia	65

Hyrje

Ajo që na dallon neve si qenie njerëzore nga qeniet e tjera është të menduarit respektivisht aftësia për ti perceptuar dhe vërejtur gjërat në një këndvështrim shumë më të avancuar në raport me të gjithë qeniet e tjera. E filloj kështu pasi që mendoj se ne, fillimisht duhet të bëjmë ndarjen në mes të mirës dhe së keqes, e më pas të zhytemi në problematika të tjera.

„A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”¹ Të bëhemi të zotët e mendjes, të marrim mësim dhe kështu që të mundemi ti perceptojmë dhe vërejmë gjërat në mënyrën e duhur dhe në dobi të shoqërisë dhe në të njëjtën kohë të mbrohemi nga të gjitha dukuritë negative të cilat tangojnë shoqërinë gjithnjë e më shumë. Bota sot respektivisht njerëzimi po ballafaqohet me sfida të ndryshme edhe atë në sfera të ndryshme, ndër më të rëndësishmet dhe të cilat përkujnë dhe me tezën që po trajtoj janë ato të sigurisë dhe ekonomisë. Termet terrorizëm, radikalizëm, ekstremizëm i dhunshëm, pasiguri, skamje, varfëri, papunësi janë bërë makth i çdo individit në rruzullin tokësor. E gjithë kjo ishte arsye për të vendosur që të trajtoj një temë të këtillë, poashtu si arsye shtesë është ndërlikdha e termit ekstremizëm i dhunshëm me fenë islame. Në këtë punim do të elaboroj çështjen e ekstremizmit të dhunshëm si një fenomen që merr përmasa gjithnjë e më të mëdha edhe atë duke sqaruar gjenezën, llojet e ekstremizmit, shkaqet e tij, viktimat e tij si dhe shumë çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me këtë problematik, në mënyrë që të na mundësohet të kemi sadopak njohuri për këtë fenomen negativ që na prek të gjithëve nëse jo në mënyrë të drejtperdrejtë, tërthorazi sigurisht. Qëllimi kryesor i këtij studimi konsiston në pajisjen me njohuri themelore në lidhje me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm. Së këndejmi, qëllimi i punimit konsiston në dy drejtime edhe atë: Njohja e ekstremizmit të dhunshëm si fenomen negativ dhe mbrojtja e shoqërisë nga ky fenomen. Në qoftë se të gjithë kontribuojmë sadopak në këtë drejtim, besoj se në mënyrë të sukseshme do të arrijmë që të mposhtim të gjitha fenomenet negative në shoqëri e jo vetëm ekstremizmin e dhunshëm. Të bëhemi të hapur, ti menjanojmë stereotipet e ndryshme dhe kështu të lirohemi nga kthetrat në të cilat duan të na katandisin disa individë apo grupacione ekstreme, për qëllime që ndoshta edhe ato vet nuk e dinë se çka në të vërtetë dëshirojnë. Të bashkuar, suksesi nuk do të mungoj. Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm është një luftë e përbashkët e njëzimt, luftë e mira kundër së keqes. Dija e dobishme të shpie në dritë, shpresoj që me anë të këtij punimi të pajisemi me dije të dobishme sa i përket kësaj problematike dhe njëherit të kontribuojmë në një mënyrë për të njoftuar dhe ndihmuar shoqërinë për tu mbrojtur nga ekstremizmi i dhunshëm.

¹ Kur'an, Sureja, Ez-Zumer, ajeti, nr. 9.

Metodologjia e hulumtimit

Për të arritur deri te një e vërtet, padyshim se duhet përdorur mjete, mënyra të caktuara respektivisht metoda. Metodatat të cilat do të shfrytëzoj për të arritur qëllimin e këtij studimi apo punimi shkencor janë : metoda historike, analitike, e intervistës, e krahasimit, e studimit të rasteve individuale si dhe metoda statistikore.

Metoda Historike-Me anë të kësaj metode do të pasqyrohet gjeneza e ekstremizmit të dhunshëm si dhe të dhëna tjera historike të rëndësishme në lidhje me këtë dukuri. Të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me historikun e ekstremizmit të dhunshëm.

Metoda analitike-Me ndihmën e kësaj metode do të bëhet analizë e thelluar dhe e detajizuar e të gjithë formave dhe shkaqeve të paraqitjes së ekstremizmit të dhunshëm, do të analizohen edhe masat për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie si dhe do të analizohen viktimat e kësaj dukurie.

Metoda e intervistës-kjo metodë do të shfrytëzohet për të intervistuarë persona kompetent, të cilët kanë njohuri të mjaftueshme në këtë sferë dhe të cilët kontribuojnë në nivelin e aftësimit të shoqërisë për tu mbrojtur nga ekstremizmi i dhunshëm.

Metoda e krahasimit-Nëpërmjet kësaj metode do të bëhet krahasimi i faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm në disa nga vendet e rajonit si Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova .Pra, do të bëhet krahasim në drejtim të konstatimit të faktorëve të cilët na shpiejnë te kjo dukuri.

Metoda e studimit të rasteve individuale-Kjo metodë do të shfrytëzohet për të studiuar rastet e caktuara të njohura si individ apo grupe të cilat bëjnë pjesë në rryma të ndryshme ekstremiste.

Metoda statistikore-Me ndihmën e kësaj metode do të furnizohemi me të dhëna të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me format dhe shkaqet e ekstremizmit të dhunshëm, viktimat e ekstremizmit të dhunshëm, numrin e pjesmarësve në formacione të ndryshme ekstremiste, të dhëna lidhur me rajonet në të cilat është më e përhapur kjo dukuri si dhe të dhëna tjera që si burim kanë statistikën.

I.Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm

1.1. Vështrim historik

Gjeneza e ekstremizmit të dhunshëm daton që në shoqëritë primitive, ku jeta ka qenë e organizuar në fise, klane, grupe ose familje edhe pse si term nuk ka qenë i njohur megjithatë veprimet e shoqërisë së atëhershme në vete përmbajnë një llojë ekstremizmi, i cili jo rallë herë është manifestuar edhe me anë të dhunës. Në shoqëritë primitive çdo individ është dashur që të veprojë në baza të rregullave të cilat i ka vendosur prijësi i fisit, klanit apo familjes. Të gjithë ato individ të cilët kanë kundërshtuar apo shkelur këto rregulla janë dëbuar nga fisi, klani apo familja. Dëbimi në kohën primitive ka qenë i barasvlefshëm me dënimin me vdekje sot. Prijësi me vendimin e tij ekstrem dhe të pamëshirshëm për dëbim, me vetëdije të plotë e ka sakrifikuar individin. Rreziqet me të cilat është përballur i dëbuari kanë qenë të paevitueshme, i njëjti është përballur ose me fisin kundërshtar i cili e ka vrarë apo skllavëruar ose me ndonjë kafshë të egër, nga e cila nuk ka mundur të shpëtoj. Veprimet e fisit kundërshtar poashtu në vete përmbajnë ekstremizëm të dhunshëm, pasi pothuajse në të shumtën e rasteve ato e kanë vrarë individin i cili ka qenë i dëbuar nga një fisi tjetër.²

Ekstremizmi i dhunshëm si term i përket kohës moderne ndërsa në thelb apo esencë mund të ndërlidhet me historinë e terrorizmit, andaj mund të thuhet se ndërlidhet me gatishmërinë e njeriut për të përdorur dhunën, si mjet, mënyrë apo metodë për të ndikuar në sfera të ndryshme.

Në shekullin e parë një grup hebrenjësh të njohur si Sicarii-të, vrisnin armiq të dhe kolaboracionistët gjatë fushatave të tyre për të përzënë sundimtarët romakë nga Judea, poashtu një sekt ekstrem islamik të njohur si Hashashin-ët, të cilët vepronin në Iran dhe Siri në shek... XI-XIII, vrisnin në mënyrë dramatike figura politike të abasitëve dhe selxhukëve për të terrorizuar kundërshtarët e tyre.³ Origjina e terrorizmit modern e cila ngërthen në vete edhe ekstremizëm daton në vitin 1793 nga Maxmilien Robespierre, i cili vrau armiq të e revolucionit dhe instaloi një diktaturë për të stabilizuar vendin, i njëjti ka besuar se dhuna të çon në një sistem më të mirë. Në vitin 1950, grupe terroriste ekstreme me agjendë nacionaliste janë formuar në çdo cep të botës. Nacionalizmi etnik irlandez, sionist, bask, kurdët në turqi, irak, siri dhe iran, tigrat çlirimtar të Tamil Elam në Shri Lankë,etj. Ekstremistë të ndryshim për motive politike në vitin 1970 terrorizojnë popullatën civile me çka edhe terrorizmi fillon të njihet ndërkombëtarisht. Ngjarja e Mynihut në lojrat olimpike të vitit 1972, ku një grup palestinez kanë vrarë disa atletë izraelitë terrorizon botën. Poashtu në vitin 1989 terroristët kanë përfutur nga tregu i zi, i armëve

² R.Halili:Penologjia,e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale,Prishtinë,2014,fq28-29

³ Amy Zalman,Historia e terrorizmit,artikull i publikuar, <http://observer.al/historia-e-terrorizmit-si-lindi-per-here-te-pare/>

,17.korrik.2015. i qasshëm më 10.shkurt.2017

të lehta të prodhimit sovjetik, pasi që bashkimi sovjetik ka qenë në prag të kolapsit, terrorizmi u shfaq edhe në SHBA, nga grupi ekstrem kundër luftës në Vietnam, të cilët protesat i shndërruan në dhunë dhe vendosën bomba në vende publike. Deri në këtë periudhë kanë qenë të njohur këto lloje terrorizmi apo ekstremizmi të dhunshëm. Pra, ai politik, nacional, etnik, vitet 1990 e këndej sjellin grupacione të ndryshme të cilët justifikojnë dhunën, me tekste fetare. Sulmet e 11 shtatorit 2001, të cilët terrorizuan popullin Amerikan, hapën një kaptinë të re sa i përket terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me pretekst fetar. Edhe pse asnjë fe nuk e proklamon dhunën, megjithatë sot janë ngritur militant ekstremist të krishter, jehudë, hindus, budist, isalmist, poashtu në këtë drejtim edhe ateistët kanë një qëndrim ekstrem të tyre. Të gjithë këto ekstremist të dhunshëm, manipulojnë me konceptet fetare për qëllime individuale dhe grupore.⁴

Lirisht mund të themi se idetë dhe veprimet ekstremiste kanë ekzistuarë gjithmonë në çdo periudhë të zhvillimit të shoqërisë edhe pse nuk është elaboruar si koncept adekuat, por janë përdorur terme të tjera. Historia e ekstremizmit të dhunshëm, e sidomos e atij me pretekst fetar shkruhet në ditët e sotme. Shpresojmë që të mësojmë sa më shumë për këtë dukuri dhe në të ardhmen mos të përsërisim gabimet e njejta. Dhuna, dëmet e ndryshme, ndasitë për motive të ulta nuk kanë vend aspak në një shoqëri të moderuar dhe mirë të konsoliduar, megjithatë natyra respektivisht egoja e njeriut për pushtet, për përfitime të ndryshme me qëllim të realizmit të dëshirave personale apo grupore, e shpiejnë shoqërinë në një humnerë, siç është edhe fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm. Duhet shumë punë për tu mbrojtur nga fenomene të këtilla negative. Ekstremizmi i dhunshëm si formë e terrorizimit të njerëzve duhet me çdo kusht të ndaloj.

⁴ Amy Zalman, Historia e terrorizmit, artikull i publikuar, <http://observer.al/historia-e-terrorizmit-si-lindi-per-here-te-pare/>, 17 korrik 2015, i

qasshëm më 10 shkurt. 2017

1.2. Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm

Për të kuptuar më qartë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm fillimisht duhet sqaruar qëllimin dhe motivin e personave të ekstremizuar. Motivet e individëve apo grupacioneve ekstreme mund të jenë të ndryshme megjithatë ato kryesisht konsistojnë në mbështetjen apo përdorimin e dhunës për të arritur qëllimet e tyre ideologjike, religjioze (fetare) ose politike.⁵ Ndonjë prëkufizim të pranuar përgjithësisht në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm nuk ka, mirëpo ekzistojnë definime të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Sipas Gus Martin „Ekstremizmi është tipar kryesor i sjelljeve të dhunshme, terroriste. Është një pikëpamje apo ideologji, radikale në mendime sidomos në çështje politike, e karakterizuar nga mungesa e tolerancës me inetrese të kundërta dhe mendime divergjente. Ekstremizmi i dhunshëm ndodh kur individ ose grupe, haptazi shprehin bindjet e tyre ideologjike nëpërmjet dhunës apo thirrjes për dhunë”.⁶

Ekstremizmi i dhunshëm është një koncept jo i definuar saktësisht, i cili në përgjithësi referohet në përdorimin e dhunës për të bartur më tej bindjet, përfshirë ato të natyrës ideologjike, politike, sociale apo religjioze. Ideja e përgjithshme në përdorimin e këtij koncepti është se mendimet apo bindjet radikale të shpien në ekstremizmin e dhunshëm.⁷ Përkufizim tjetër “Ekstremizmi i dhunshëm paraqet bindjet dhe veprimet e personave të cilët bëjnë thirrje, mbështesin ose përdorin dhunë për të arritur qëllimet e tyre ideologjike, religjioze apo politike”.⁸ Gjithsesi, në qoftë se një person apo grup vendos që për të arritur qëllimet ideologjike, politike apo religjioze, të justifikojnë shpërndarjen e frikës në shoqëri terrorin apo dhunën dhe të veprojnë në përputhje me këtë sitautë atëherë kjo në mënyrë të patjetërsueshme të shpien në ekstremizëm të dhunshëm.⁹ Në aspekt fetar ekstremizëm konsiderohet çdo rëndim apo shtrëngim i dispozitave fetare.

Nga gjithë këto definime, mund të konkludojmë se ekstremizmi i dhunshëm, polarizon individ apo grupacione të cilët për të arritur objektivat e tyre, mjet të domosdoshëm e shohin përdorimin e dhunës ose nxisin apo bëjnë thirrje për dhunë, më anë të së cilës ato dëshirojnë të bëjnë ndryshimet ideologjike, politike, sociale apo religjioze, brenda territorit të një vendi të caktuar apo edhe në tërë globin. Përkufizimi më adekuat për ekstremizmin e dhunshëm do të ishte se me të nënkuptohet dëshira për të arritur ndryshim ideologjik, politik apo religjioz me anë të dhunës.

⁵ <https://www.livingsafetogether.gov.au/aboutus/Pages/what-is-violent-extremism.aspx>, Motivations for violent extremism, i qasshëm më 11.shkurt.2017

⁶ G.Martin, Terroris and Homeland Security. SAGE publications, Thousand Oaks, CA, 2001, p.4.

⁷ Marco Lombardi, Eman Ragab, Vivienne Chin, Yvon Dandurand, Valerio de Divitiis, Alessandro Burato, “Countering Radicalisation and Violent Extremism Among Youth to Prevent Terrorism”, Milan, Italy 10-13 June 2014, p.25.

⁸ <https://www.livingsafetogether.gov.au/aboutus/Pages/what-is-violent-extremism.aspx>, What is violent extremism. i qasshëm më 11.shkurt.2017

⁹ <https://www.livingsafetogether.gov.au/aboutus/Pages/what-is-violent-extremism.aspx>, What is violent extremism. i qasshëm më 11.shkurt.2017

1.3. Llojet e ekstremizmit të dhunshëm

Ekstremizmi i dhunshëm mund të shfaqet në forma apo lloje të ndryshme, megjithatë në cilën do formë të paraqitur, për synim ka përdorimin e dhunës apo idenë e thirrjes ose nxitjes së dhunës. Veprimet ekstremiste pak a shumë ngjasojnë me ato terroriste, shumë autor kanë bërë klasifikimin e llojeve të terrorizmit por jo edhe atë të ekstremizmit të dhunshëm. Para se me bërë klasifikimin e llojeve të ekstremizmit, duhet theksuar se të gjitha llojet e kësaj dukurie në një apo mënyrë tjetër kanë prapavijë politike.

Ekzistojnë disa lloje të ekstremizmit të dhunshëm edhe atë:

1. Ekstremizmi i dhunshëm me pretekst religjioz.
2. Ekstremizmi i dhunshëm politik.
3. Ekstremizmi i dhunshëm etnik.
4. Ekstremizmi i dhunshëm nacional.
5. Ekstremizmi i dhunshëm racor.

1. Ekstremizmi i dhunshëm me pretekst religjioz, gjithnjë e më shumë është duke u përhapur. Sot në botë ekzistojnë shumë individ apo grupacione të cilët duke devijuar konceptin e feve, radikalizojnë, ekstremizojnë, indoktrinojnë shumë njerëz, e më pas të njëjtit i flijojnë apo i bëjnë „kurban” për qëllimet dhe interesat e tyre. Pra, interesi i tyre nuk është feja, por realizmi aspiratave të ndryshme politike duke keqpërdorur vlerat fetare.

Ndër grupacionet të cilët kanë qëndrime ekstreme me prapavijë fetare islame, e të cilët në fakt nuk kanë asnjë lidhje me fenë islame janë: I ashtuquajturi shteti islamik apo ISIS, Al-qaeda, Al Nusra, të ashtuquajturit „selef” të vërtet si dhe shumë grupacion të tjera. Grupacione të feve tjera, të krishter: Shoqëria kishtare amana-kisha e inspirimit të vërtet, kuvendarët e ushtarëve të krishterë, kisha e izraelit, antoinizmi, grupi i vëllezërve Jim Roberts, etj. Budist: Lëvizja budiste amerikane, aum shinrikyo-aleph, lëvizja dalite budiste, miqtë e rendit budist perëndimor, etj. Hindus: adidam(deistët e lirë), andanda marga, arya samaj, etj.¹⁰

2. Ekstremizmi i dhunshëm politik, paraqet një llojë ekstremizmi i cili konsiston në arritjen e interesave politike me anë të përdorimit të dhunës ose thirrjes apo nxitjes për dhunë. Personat e inkorporuar në organizata të këtilla ekstremiste, dhunën e konsiderojnë mjet të domosdoshëm për arritjen e qëllimeve të tyre politike. Grupacionet e këtilla poashtu kryejn veprime të ndryshme të dhunshme me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së opinonit të gjërë me qëllim të realizmit të interesave të tyre. Grupacione të këtilla mund ti përmendim: Partia punëtore e kurdistanit, ITA, ETA, Tigrat Tamilë, etj.¹¹

¹⁰ F.Kamberi, Fundamentalizmi i religjioneve të mëdha moniste dhe globalizmi, Shkup, 2015, fq.244-255.

¹¹ Po aty, fq.151.

3. Ekstremizmi i dhunshëm etnik, mund të definohet si lloj ekstremizmi i cili ka për qëllim realizmin e intereseve në favor të një etnie apo etnikumi duke shkelur apo shtypur një etnikum tjetër, nënkuptohet e gjithë kjo të realizohet me përdorimin e dhunës ose thirrjes apo nxitjes për dhunë. Rasti me eklatant i shprehur i këtij lloj ekstremizmi në rrethin tonë respektivisht në Ballkan është ai i regjimit të Milosheviqit ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Në vitin 1998-1999, forcat serbo-sllave me anë të dhunës tentuan të dëbojnë popullin e Kosovës nga trojet e veta dhe në këtë mënyrë të realizojn interesin e tyre, atë të sundimit të territoreve të tokave shqiptare. Si raste të tjera mund të përmenden, çeshtja çame në Greqi, dëbimi i shqiptarëve nga territori i R.M.,së për në Turqi në kohën e Rankoviqit, etj.

4. Ekstremizmi i dhunshëm nacional, është një llojë ekstremizmi ku rol shumë të rëndësishëm luan mënyra e ushtrimit të pushteti shtetëror. Vjen në shprehje në vende apo shtete të ndryshme, megjithatë më i theksuar është në vende multietnike, në të cilat pushteti shtetëror nuk i trajton qytetarët e tij në mënyrë të barabartë, respektivisht disa qytetarë i llogarit si të dorës së dytë. Pra, në vende ku një komunitet është më i privilegjuar në raport të disa komuniteteve të tjera, të cilët përbëjnë strukturën e popullsisë së atij shteti. Shembuj praktik të këtij lloj ekstremizmi të dhunshëm kemi shumë në R.M.,së. Sot në vendin tonë, veprojnë shumë organizata nacionaliste të cilat bëjnë thirrje nxisin apo përdorin dhunë me arsyetimin kinse atyre u rrezikohet shteti. Të njëjtit në këtë mënyrë polarizojnë dy komunitetet më të mëdha në vend dhe jo të pakta janë rastet ku është përdorur dhuna, e që është për të ardhur keq e njëjta nuk është ndëshkuar nga organet kompetente ligjzbatuese, respektivisht kur ka ardhur deri te drejtshmëria e zbatimit të ligjit ka pasur standarte të dyfishta.

5. Ekstremizmi i dhunshëm racor, më i shprehur në periudha të ndryshme historike ka qenë në SHBA. Ky lloj ekstremizmi konsiston në përdorimin e dhunës ose thirrjes apo nxitjes për dhunë, kundër një race të caktuar me të vetmin arsyetim sepse „ ata nuk kanë të njëjtën ngjyrë sikurse ne “. Nga vështrimi historik, të zinjët në SHBA kanë qenë të diskriminuar në sfera të ndryshme për skhak të ngjyrës. Në të shumtën e rasteve ato janë konsideruar apo etiketuar si kriminel potencial, vetëm përshkak të ngjyrës së lëkurës. Organizma ekstreme akoma veprojnë si p.sh. personat me ngjyrë të zezë gjithnjë sulmohen nga kju kluks klani, megjithatë e gjithë kjo dukuri ka tashmë qasje tjetër duke u bazuar në atë se për 8-tetë vite në krye të SHBA, ka qenë presidenti Obama si një person me ngjyrë.

Të gjithë këto lloje të ekstremizmit të dhunshëm, në një mënyrë na sqarojnë dëshirën e individëve apo grupacioneve të caktura, duke keqpërdorur më të shenjtat siç janë feja,kombi dhe raca për të përmbushur egon e tyre për pushtet ose për ndikim në shoqëri dhe të gjithë këtë përmes rrugës më të tmerrshme atë të dhunës, përdorimit të saj ose nxitjes apo thirrjes për të. Pra, ashtu siç u theksua edhe më lartë të gjithë këto lloje të ekstremizmit të dhunshëm kanë prapavijë politike, e cila konsiston në arritjen e vendosjes së një raporti reciprok shoqëror, ku njëra palë do të vendos rregullat ose do të urdhëroj ndërsa pala tjetër apo të gjithë të tjerët do të duhet të sillen në bazë të atyre rregullave të vendosura nga ana e tyre.

1.4. Lidhshmëria e ekstremizmit të dhunshëm me terrorizmin

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmi janë ndër termet të cilët përmes njerëzimit, ato janë shumë të ngjajshëm në esencë pasi që të dyja këto terme konsistojnë në përdorimin e dhunës, megjithatë në terminologji dallojnë. Përderisa te ekstremizmi i dhunshëm dhuna, thirrja ose nxitja për të janë mjet i domosdoshëm për të arritur ndryshimet ideologjike, politike dhe fetare, tek terrorizmi dhuna është mjet për të terrorizuar, frikësuar, për të mbjell pasiguri në mesin e njerëzve apo tmerrur ato. Fjala terrorizëm e ka prejardhjen nga gjuha latine „terroris” që do të thotë frikë e madhe, tmerr, terror apo pasiguri.¹² Është shumë e rëndësishme të theksohet se ekstremizmi mund të jetë një shenjë paralajmëruese për terrorizmin, bindjet ideologjike nuk mund në mënyrë të pavarur të arrijnë në prag të një akti terrorist, natyrisht kjo arrihet përmes dhunës, andaj kemi një dallim të qartë në mes të „terrorizmit” dhe „ekstremizmit të dhunshëm”. Përderisa individët apo grupacionet e ekstremizuar nuk e mbështesin dhunën në mënyrë të qartë bindjet dhe ideologjia e tyre është e mbrojtur me ligje pozitive të çdo vendi, si liri e të shprehurit dhe menduarit. Pra, ata persona të cilëve në mendje ju sillen vetëm ideja ekstreme, por të njëjtat nuk i veprojnë në këto raste janë të mbrojtur, pasi që ideja për diçka edhe pse sado e tmershme mund të jetë nuk është e ndëshkueshme.¹³

Individ ose grupacione të ekstremizuara në të shumtën e rasteve përfundojnë në organizata terroriste, te këto njerëz dhuna është parësore andaj për të arritur qëllimet e veta ata aderimin në organizata terroriste e shohin si diçka që ua mundëson një gjë të tillë. Bota është tmerruar nga sulme të ndryshme terroriste më të prekura nga këto sulme janë vendet e lindjes së mesme- Irak, Avganistan, Siri, Turqia, shtetet e Evropës (më të prekura, Gjermania, Franca, Belgjika), SHBA si dhe shumë vende apo shtete të tjera janë potencial për akte të dhunshme terroriste. Terroristët nuk ngërthejnë në vete asnjë fe, komb, racë, nacionalitet, kulturë, poashtu nuk përfshijnë as kufij por ato janë antivlera më e madhe njerëzore, e cila preokupon sot njerëzimin. Personat e ekstremizuar mund të thuhet se janë „gjahu” i organizatave të ndryshme terroriste. Ato duke shfrytëzuar një gjendje të caktuar të këtyre personave, krijojnë mundësinë e shfrytëzimit të tyre për qëllimet e organizatës. Thënë ndryshe, personat e ekstremizuar më lehtë bijen në kthetrat e organizatave terroriste, pasi të njëjtit nuk kanë një nivel të caktuar të koshiençës për të perceptuar ngjarjet apo ndodhitë, por veprojnë me emocione apo gjendje të ndryshme shpirtërore dhe në këtë mënyrë ato bëhen autor vizavi viktimit (te sulmet vetëvrasëse) të krimeve të caktuara. Nga kjo mund të konstatojmë se terrorizmi respektivisht kërket e organizatave të ndryshme terroriste, shfrytëzojnë gjendjen e personave të ekstremizuar për të arritur objektivat e veta, andaj jo rastësisht këto dukuri janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën.

Brenga më e madhe e terroristëve është mënyra se si ato të rekrutojnë sa më shumë njerëz në organizatat e tyre terroriste, ndërsa brenga e shoqërisë përkatësisht shteteve në anën tjetër

¹² R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.165.

¹³ E.Southers, Homegrown Violent Extremism, London, 2013, p.4.

është gjetja e mekanizmave adekuate për parandalimin dhe luftimin e këtyre fenomenve të rrezikshme për të gjithë shoqërinë. Shumica e shteteve apo pothuajse të gjithë shtetet në botë, në legjislacionet e tyre penale kanë paraparë terrorizmin apo aderimin në organizatë terroriste si vepër penale dhe ndëshkueshmërinë për të në bazë të neneve përkatse. Sa është adekuat kjo mënyrë e luftimit të këtij fenomeni mbetet të shihen rezultatet në të ardhmen.

Në R.M.-së, terrorizmi në bazë të kodit penal është i ndëshkueshëm edhe atë në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër shtetit është paraprë edhe vepra penale e terrorizmit „Ai i cili me qëllim të cenoj rendin kushtetues ose sigurinë e R.M.së, do të shkaktojë apo seriozisht do të kërcënoj se do të shkaktoj eksplozjon, zjarr, përmbytje apo ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm ose akt të dhunshëm, duke krijuar kështu pasiguri ose frikë tek qytetarët, do të dënohet më së paku me 4-katërt vite burgim”.¹⁴ Nga ana tjetër „organizatave terroriste nuk u hynë në punë se a ndëshkohet terrorizmi ose jo, por ato vazhdojnë aktivitetet e tyre deri në realizmin e qëllimeve dhe objektivave të tyre dhe në këtë mënyrë ato sot shfrytëzojnë metoda të ndryshme për të rekrutuar sa më shumë individë apo pse jo edhe grupe njerëzish në të njëjtën kohë në gjirin e tyre. Zhvillimi i teknologjisë u ka krijuar mundësi të shumta që më lehtë të arrijnë në objektivat e tyre „ato sot duke shpërndarë materiale të ndryshme propaganduese nëpërmjet rrjeteve sociale arrijnë të rekrutojnë shumë njerëz dhe në këtë mënyrë, të realizojnë aksione apo akte terroriste në vende të ndryshme të botës. Fakt tjetër shumë brengosës është se sot organizatat terroriste në të shumtën e rasteve aksionet e tyre i realizojnë përmes „ushtarëve të vdekjes” apo sulmeve vetëvrasëse, sulme këto thuajse të pamundshme për tu shmangur, respektivisht për të gjetur një metod adekuate për ti parandaluar.

Ndër organizatat ekstremiste dhe terroriste më të njohura që veprojnë në vende të ndryshme të botës janë: „ISIS” në Siri dhe Irak, „Al-qaeda” në Afganistan, Siri, Irak, „ Hamas” dhe „Hazbullah” në Liban, „PKK” në Turqi, „ETA” e baskëve të Spanjës, „IRA” në Irlandën Veriore dhe Angli, „Brigadat e kuqe” në Itali, „RAF” në Gjermani, „FIS” në Algjeri, „Abu Sayaf” në Filipine, „17 nëntori” në Greqi, etj.¹⁵

¹⁴ Shih në, <http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20precisten%20%20tekst.pdf>, i qashtëm më 13.shkurt.2017

¹⁵ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.167

II. Fenomeni i ekstremizmi të dhunshëm

2.1. Ekstremizmi i dhunshëm, sfidë e botës bashkëkohore

Që në fillet e njerëzimit gjërat janë sfiduar njëra me tjetrën, sfidat vazhdojnë edhe ditët e sotme, e mira sfidohet nga e keqja, jeta sfidohet nga vdekja (vrasjet), morali sfidohet nga imoraliteti, paqja, qetësia, siguria sfidohen nga dhuna, terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm radikalizimi, lufta e kështu me rradhë. Një ndër dukurit apo fenomenet që e shqetëson botën sot respektivisht që e cenon sigurinë e saj është fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm. Nuk ka vend në botë që nuk është preokupuar sadopak në lidhje me këtë fenomen të rrezikshëm për mbarë shoqërinë. Të gjitha vendet vizavi shtetet bëjnë përpjekjet e tyre për ti mbrojtur qytetarët e tyre nga çdo fenomen i rrezikshëm përfshirë këtu dhe ekstremizmin, pasi që një ndër prioritetet apo detyrat kryesore të çdo qeverie është ruajtja e paqes dhe stabilitetit në vend.

Për të dëshmuar se fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm paraqet sfidë për botën bashkëkohore, mund ta argumentojmë duke filluar nga rezoluta e miratuar nga ana e këshillit të sigurimit të OKB-së në lidhje me këtë fenomen. Në bazë të kësaj rezolute 2178 të këshillit të sigurimit të OKB-së (v.2014), “Vendet anëtare duhet të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të parandalojnë rekrutimin, organizmin, transportimin ose pajisjen e individëve të cilët udhëtojnë në një shtet tjetër nga shteti ku jetojnë për qëllimin e kryerjes planifikimit ose pjesëmarrjen në akte terroriste apo dhënie ose marrjen e trajnimit për terrorizëm, ashtu si dhe financimin e udhëtimit të tyre apo të aktiviteteve të tyre”. Poashtu në këtë drejtim edhe Komisioni Evropian me 2 dhjetor 2015 ka miratuar një paket të dyfishtë kundër këtij fenomeni.¹⁶ Të gjitha shtetet në mënyrë të vaçantë kanë ndryshuar legjislacionet e tyre në sferën penale, pothuajse në të gjithë shtetet veprimet që në vete mbajnë dozë të ekstremizmit të dhunshëm radikalizmit, terrorizmit janë të ndëshkueshme. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka zënë edhe dukuria e luftëtarëve të huaja, pasi që organizatat ekstreme terroriste në vete dëshirojnë të ngërthejnë sa më shumë luftëtar, shembull konkret ISIS përdor metoda të ndryshme për të rekrutuar sa më shumë luftëtar ose ithtarë, pasi jo të paktë janë rastet ku persona kanë kryer sulme të ndryshme, jo duke u kyçur direkt në këtë organizatë por duke qenë ithtarë të tyre, të njëjtit kanë qenë të motivuar nga veprimet të cilat shfaqen në media apo rrjete sociale të ndryshme. Në bazë të KPM-së edhe terrorizmi edhe pjesëmarrja në forca, ushtri të huaja janë paraparë si vepra penale dhe të njëjtat janë të ndëshkueshme. Megjithatë mbetet të mësohet nga koha se të gjithë këto mekanizma për parandalimin, përballjen dhe luftimin e këtyre fenomeneve janë efikase ose jo. Ajo që na takon neve është nevoja e patjetërsueshme e trajtimit të këtij fenomeni në opinion dhe në këtë mënyrë të kontribohet në senzibilizimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë për tu ballafaquar me këtë fenomen dhe shumë fenomene negative të tjera. Masa e gjerë ka nevojë të informohet në lidhje me këtë fenomen, që çka në të vërtetë ka për synim apo cili është misioni i personave të radikalizuar, ekstremizuar dhe kështu më pas të ndërtoj një strategji adekuate dhe efikase për tu mbrojtur. Për fat të keq sot disa shtete veprojnë në mënyrë

¹⁶ K.Selimi & F.Stojkovski, “Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm pikëpamje nga shoqëria civile”, fq.5-6.

hipokrite deklartivisht e luftojnë ekstremizmin e dhunshëm ndërsa me veprimtaritë e tyre ndihmojnë grupet e ekstremizuara. Shembull në këtë drejtim është situata e krijuar në lidhje me ISIS, nuk është e llogjikshme që për një periudhë të shkurtër një organizatë e tillë ekstremiste dhe terroriste, të forcohet aq shumë sa që të gjitha shtetet ta luftojnë dhe përsëri të mos mund ta eliminojnë, andaj këtu shfaqet hipokrizia se disa shtete nën hije e ndihmojnë, normal kuptohet për të realizuar interesat e tyre. Përderisa veprohet kështu bota gjithnjë do të sfidohet nga fenomene të ndryshme negative, megjithatë e mira dhe e vërteta në fund do të ngadhenjejnë, pasi që shumica e shoqërisë synon nga e mira e jo nga veset negative të cilat shpiejnë në humnerë edhe ato të cilët mendojnë se në sajë të tyre do të arrijnë ndonjë ndryshim ideologjik, politik ose fetar. Mund të thuhet se sfidat në disa raste janë të “mirëseardhura” sepse pas ballfaqimit me to, individit, grupit ose shoqëria në përgjithësi del më e fortë dhe më e bashkuar.

2.2. Disa veçori të ekstremizmit të dhunshëm

Duke sqaruar veçoritë e një fenomeni të caktuar në këtë rast atë të ekstremizmit të dhunshëm, kuptojmë më mirë esencën apo elementet themelore të tij. Vëllimi, struktura dhe dinamika e ekstremizmit të dhunshëm, por edhe të të gjitha fenomeneve apo dukurive të tjera më mirë pasqyrohet në bazë të të dhënave statistikore.¹⁷ Termi ekstremizëm i dhunshëm në terminologji është i ri, megjithatë i njëjti mund të ndërlidhet me forma të ndryshme të sjelljeve kriminale duke u bazuar në atë se synim kryesor ka dhunën, nxitjen ose thirrjen për të. Të gjitha ato sjellje kriminale të cilat çënojnë vlerat themelore të shoqërisë, në të gjithë sistemet ekonomike shoqërore trajtohen si krim ose si vepra penale, këtu mund të përmenden mbrojtja e jetës dhe trupit, mbrojtja e pronës, mbrojtja e nderit, etj. Të gjitha këto vlera janë të cënuara nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm.¹⁸

Duke u bazuar në të dhëna rreth asaj se në cilat zona është më i përhapur fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm, cila është mosha dhe gjinia e personave të cilët më lehtë mund të radikalizohen respektivisht të ekstremizohen, gjendja martesore apo statusi familjar i tyre si dhe gjendja sociale apo statusi social, do të sqarojmë fenomenologjinë e këtij fenomeni. Në bazë të kësaj mund të identifikojmë se veçoritë e ekstremizmit të dhunshëm në përgjithësi nuk dallojnë nga veçoritë e kriminalitetit të përgjithshëm, megjithatë ato i kanë specifikat e veta që nënkupton se ka dallime. Mjafton që në bazë të veçorive të krijojmë mekanizëm adekuat për tu mbrojtur nga ky fenomen negativ.

¹⁷ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 115-116.

¹⁸ Po aty, fq. 126.

2.3. Zonat në të cilat është më i përhapur fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm

Klasifikimin e zonave (vendet, shtetet) në të cilat është më i përhapur fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm mund ta bëjmë duke u bazuar në llojet e tij dhe në këtë mënyrë të konstatojm se cili lloj në cilën vend apo shtet është më i përhapur. Me rëndësi është të shpjegohet se ky fenomen nuk kufizohet në një vend ose shtet të caktuar, megjithatë këtu qëllimi është të sqarojm se në cilët pjesë është më i përhapur.

Ngjarja e 11 shtatorit 2001 në SHBA nxori në pah ekstremizmin e dhunshëm me pretekst religjioz respektivisht i dha një hovë më të madh kësaj dukurie, pasi që e njëjta ka ekzistuar edhe në të kalurën por jo me këtë emërtim. Prej sulmit të kullave binjake deri më sot kanë ndodhur shumë ngjarje të tjera të cilat janë shprehur me dhunë e të cilat kanë pasur për pretekst ndonjë religjion të caktuar.¹⁹ Sot në vende të ndryshme veprojnë organizata ekstremiste terroriste dhe kanë marrë fuqi të madhe, preokupimi më i madhë është i ashtuquajturit shteti islamik apo ISIS. Kjo organizatë zotron territore të konsiderueshme në Siri dhe Irak, territore këto në të cilat e njëjta ka shpallur edhe shtetin e vet apo të njohur si Kalifat. ISIS ka marrë përsipër një sërë sulmesh nëpër vende të ndryshme të botës edhe atë nga këto sulme kanë pësuar Gjermania, Franca, Belgjika, Turqia, Egjipti, Tunisi, etj.²⁰ Organizatë tjetër e cila vepron poashtu me këtë pretekst është Boko Haram në Nigeri, e njëjta ndjek të gjitha veprimet e ISIS dhe terrorizon pjesën e Afrikës.²¹ Në Israel poashtu është i shfaqur ky lloj ekstremizmi, grupacione të caktuara me ndihmën edhe të autoriteteve nën pretekst fetar tentojn me anë të dhunës ti dëbojnë besimtarët musliman nga kompleksi i xhamisë Al-Aksa.²² Poashtu nën pretekst fetar në Myanmar (Burma) nga budistët ekzekutohen në mënyrë më mizore të mundshme besimtarët musliman.²³ Pra, rajoni më kritik në të cilën ky lloj ekstremizmi është më i përhapur është ai i vendeve të Lindjes së mesme, kryesisht Siria, Iraku, Afganistani, Israeli, Irani, Myanmar, poashtu një pjesë e Afrikës. Por, megjithatë veprimtaria e këtyre ekstremistëve të dhunshëm nuk kufizohet vetëm në këto vende, ato aktivitetet e tyre tentojnë ti kryejnë në çdo vend, varësisht prej mundësive respektivisht situatës së caktuar. Qëllimi i tyre është të shfrytëzojnë çdo moment adekuat për të shfaqur dhunën dhe për të terrorizuar njerëzimin në përgjithësi. Viktimë e mundshme e ekstremizmit të dhunshëm me pretekst religjioz mund të jëtë çdo vend apo shtet në botë.

Ekstremizmi i dhunshëm politik gjithashtu është shumë i përhapur, i njëjti në të shumtën e rasteve shprehet në mënyrë indirekte dhe kështu nga kjo situatë pësojnë vendet apo shtetet e treta. Sot, ky lloj ekstremizmi më shumë shprehet nga superfuqitë botërore kryesisht nga SHBA

¹⁹ F.Kamberi, Fundamentalizmi i religjioneve të mëdha moniste dhe globalizmi, Shkup, 2015, fq.145.

²⁰ Shih në, <http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/islamic-state/11629161/Mapped-The-countries-facing-the-greatest-threat-from-Islamic-extremists.html>, publikuar më 26.maj.2015. i qasshëm më 16.shkurt.2017

²¹ Shih në, <http://www.bbc.com/news/world-africa-13809501>, publikuar më, 24.nëntor.2016. i qasshëm më 16.shkurt.2017

²² Shih në, <http://time.ikub.al/Perleshje-ne-Jeruzalem-trazirat-largojne-rifillimin-e-procesit-te-pages3786/Trazira-ne-Al-Aksa-xhamia-e-shenjte-ne-Jeruzalem2391.aspx>, publikuar më, 26.korrik.2015. i qasshëm më 16.shkurt.2017

²³ Shih në, [http://www.forumishqiptar.com/threads/144664-Vrasje-Masive-e-Muslimaneve-ne-Burma-\(-Maynmar\)](http://www.forumishqiptar.com/threads/144664-Vrasje-Masive-e-Muslimaneve-ne-Burma-(-Maynmar)), publikuar më 07.tetor.2012. i qasshëm më 16.shkurt.2017

dhe Rusia si dhe nga ithtarët e tyre e njëjta përkrahet. Për ta bërë më të qartë, këta shtete nuk duhet etiketuar si shpërndarës së dhunës, megjithatë për të realizuar interesat e tyre politike respektivisht për të arritur ndonjë ndryshim ideologjik, politik ose fetar ato në situata të caktuara mbështesin dhunën dhe jo të pakta janë rastet kur ato kanë ndërhyrë edhe ushtarakisht nën pretekst për të instaluar „demokracinë”. Konfliktet që zhvillohen në vendet e lindjes së mesme, nxjerin në pah ndikimin e superfuqive të përmendura.²⁴ Në të gjithë ato shtete të lindjes së mesme bëhet luftë për pushtet e jo ashtu siç manipulohet në opinion kinse për motive religjioze. Pothuajse në të gjithë shtetet të cilët ekonomikisht dhe ushtarakisht janë të dobët ekzistojnë forca politike të ndara në pro SHBA ose pro Evropiane (NATO) nga njëra anë dhe nga ana tjetër pro Ruse. Ndarje kjo që u ofron siguri sadopak shteteve ithtare të superfuqive. Interesat politike të SHBA dhe Rusisë janë të kundërta, andaj gjithnjë midis tyre do të ketë një „luftë” indirekte dhe për fat të keq këtë do ta pësojnë shtetet e treta. Shembull konkret është lufta civile për pushtet në Siri, SHBA publikisht përkrah forcat rebele kundër regjimit të Asadit, ndërsa Rusia përkrah regjimin e tij dhe si rezultat i kësaj lufta civile prej marsit të 2011 e deri më sot nuk ka të ndalur.²⁵ Në këtë drejtim Franca ka akuzuar Rusinë për krime lufte në Siri, me çka pasoi dekreti i presidentit të Rusisë Vladimir Putin, për tërheqjen e saj nga Gjykata penale ndërkombëtare.²⁶ Konstatim i përgjithshëm është se ky lloj ekstremizmi, përhapet varësisht prej situatës momentale të krijuar dhe nuk specifikohet apo lidhet konkretisht me ndonjë vend ose shtet të caktuar.

Ekstremizmi i dhunshëm etnik dhe nacional është më i përhapur në vende në territoret e të cilëve ka diversitet të etnive, kulturave dhe feve, respektivisht vende të cilat kanë popullsi me identitet të ndryshëm kombëtar, religjioz, kulturor e kështu me rradhë. Në të gjitha këto raste për shkak të dallimeve ose ndasive që ekzistojnë në strukturën e popullsisë së atij vendi, ekziston rrezik më i madh që mund të vijë deri të thirrja, nxitja ose mbështetja e dhunës për ndonjë interes të karakterit etnik apo nacional. Si vende tipike në të cilat kanë ardhur në shprehje këto lloje të ekstremizmit janë shtetet e ish Jugosllavisë. Dhuna e shfaqur nga Serbia ndaj popullatës së pafajshme të Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë dhe Kosovës, problemet ndërmjet komuniteteve më të mëdha në R.M.,së, paraqesin shembuj konkret të këtyre ekstremizmave.²⁷

Ekstremizmi i dhunshëm racor, historikisht është shprehur në SHBA ndërmjet të bardhëve dhe të zinjëve atje, megjithatë edhe sot ekziston por nuk është i shprehur shumë dhe më tepër konsiston në thirrjen për dhunë se sa në përdorimin e saj.²⁸

²⁴ Shih në, <http://www.balkanweb.com/gazetashqiptare/rusia-komplikon-ekuilibrat-ne-lindjen-e-mesme/>, publikuar më 7.shtator.2015. i qasshëm më 18.shkurt.2017

²⁵ Shih në, <http://lajmpress.com/si-nisi-lufta-civile-ne-siri-mes-qeverise-dhe-opozites/>, publikuar më 17.nëntor.2015. i qasshëm më 18.shkurt.2017

²⁶ Shih në, <http://aa.com.tr/sq/bota/rusia-largohet-nga-gjykata-penale-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/687052>, publikuar më 16.nëntor.2016. i qasshëm më 18.shkurt.2017

²⁷ Shih në, <http://telegrafi.com/konfliktet-e-pambaruara-ne-ballkan/>, publikuar më 16.maj.2015. i qasshëm më 18.shkurt.2017

²⁸ Shih nw, <https://www.theatlantic.com/politics/archive/2016/05/racism-commentary-obama-trump/481329/>, publikuar më 5.maj.2016. i qasshëm më 18.shkurt.2017


2.4. Moshë dhe gjinia e personave të radikalizuar

Radikalizimi i individëve dhe grupeve të caktuara është një ndër elementet themelore që shpjen në ekstremizmin e dhunshëm. Organizatat e ndryshme ekstremiste dhe terroriste dëshirojnë që fillimisht të radikalizojnë sa më shumë individë ose grupe dhe më pas të njejtin ti shfrytëzojnë për realizimin e planeve të tyre. Ekziston një klasifikim ligjor i grupmoshave edhe atë personi prej 0-14 vjet llogaritet fëmijë, prej 14-18 vjet llogaritet i mitur dhe prej 18+ llogaritet person i moshës madhore, poashtu ekziston një klasifikim në bazë të përgjegjshmërisë në: persona të përgjegjshëm ose persona me përgjegjësi të plotë, persona me përgjegjësi të kufizuar dhe persona të papërgjegjshëm. Në qoftë se individë ose një grup i caktuar kryen ndonjë krim, normalisht për këtë duhet të përgjigjet. Në bazë të përgjegjësisë personat klasifikohen në këtë mënyrë: personat 0-14 vjet llogariten fëmijë dhe nuk kanë përgjegjësi ligjore, në të kaluarën personat prej moshës 14-18 vjet janë llogaritur të mitur dhe poashtu ka pas një klasifikim në të mitur të rinjë 14-16 vjet dhe të mitur të rritur 16-18 vjet dhe në bazë të këtij klasifikimi është bërë edhe llogaritja e përgjegjësisë, mirëpo me ndryshimet e bëra edhe këta grupmosha llogariten fëmijë megjithatë nëse kryejn ndonjë krim kanë përgjegjësi dhe llogariten si fëmijë që janë në kundërshtim me ligjin prej moshës 14-18 vjet, ndërsa personat e moshës madhore 18+ kanë përgjegjësi të plotë ligjore, normal në të gjithë këto raste bëhet fjalë për persona të përgjegjshëm.²⁹ Duke u bazuar në rastet konkrete, në praktik nga të dhënat statistikore lidhur me numrin e pjesmarrësve në organizata ekstremiste mund të konkludojmë se si grupmosha më të rrezikuara për tu radikalizuar janë kryesisht grupmoshat e reja 14-21 vjet dhe ajo e mesme 21-40 vjet. Tek këto persona mund të manipulohet më shpejtë dhe kështu duke bërë „shpërlarjen e trurit të tyre” përfundojnë në organizata ekstremiste. Natyrisht motivet për të ju bashkangjitur një grupacion ekstrem mund të jenë të ndryshme duke filluar nga kushtet e rënda të jetesës për shkak të luftës kjo vlen më së shumti për individët ose grupet në vendet e të cilëve zhvillohet luftë, varfëria e skajshme, mungesa e edukimit të përgjithshëm dhe shkencor, vrasja e ndonjë të afërmi ose e tërë familjes si dhe një sërë shkaqësh të tjera.³⁰ Grupacionet ekstreme shfrytëzojnë mjete propaganduese shumë të fuqishme dhe në këtë mënyrë arrijnë të radikalizojnë persona edhe nga vise të tjera ku ato nuk ushtrojnë pushtet. Shumë të rinjë nga viset e Evropës por edhe e nga e tërë bota i janë bashkangjitur organizatës ekstremiste terroriste ISIS si pasojë e propagandës së tyre, në të cilën ato i kanë perfeksionuar gjërat sa që me bashkangjijtjen në grupacionin e tyre individë ose grupi i arrijnë të gjitha. Variant tjetër i përdorur nga grupacionet ekstreme është edhe ajo e shfrytëzimit të ithtarëve të tyre në vende të ndryshme të botës dhe në këtë mënyrë detyrimi vizavi motivimi i tyre për të kryer sulme terroriste në vendet e tyre, në këtë drejtim më të njohura janë sulmet vetëvrasëse por edhe sulmet e njerëzve në vende të ndryshme publike. ISIS është organizata me numër më të madh militantësh të ekstremizuar me një ideologji kinse islame, e cila në realitet ska të bëjë aspak me islamin. Numri i pjesëtarve të ISIS fillimisht është llogaritur diku prej 20 mijë deri në 30 mijë pjesëtar dhe më pas ky numer ka

²⁹ I. Zejneli, Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonis, Tetovë, 2010, fq. 65-66.

³⁰ Shih në, <http://www.thedailybeast.com/articles/2015/12/05/how-young-brains-get-radicalized.html>, publikuar më 12. Maj. 2015. I qasshëm më 28. shkurt. 2017

variuar në shifra të ndryshme dhe sipas të dhënave të shërbimit të intelgjencës amerikane, numri i militantëve është shumëfishuar dhe kapë diku me qindramijëra pjesëtarë.³¹ Në bazë të moshës 78% e militantëve janë prej 18-30 vjet dhe 22% janë prej 30-60 vjet, mbi 60 vjet 0%. Shumica e tyre apo 73% kanë njohuri elementare fetare, 22,5% kanë njohuri mesatare dhe 4.5% kanë njohuri shariatike.



Të dhëna statistikore lidhur me pjesëtarët e ISIS.³²

Në bazë të gjinisë, duke u bazuar në të dhëna nga statistika kriminale dhe praktika gjyqësore sjelljet kriminale gjithnjë u janë adresuar meshkujve, megjithatë jo të pakta janë rastet kur femrat kanë kryer sjellje kriminale, andaj mund të thuhet se edhe meshkujt edhe femrat janë të prirur për të kryer krime të ndryshme varësisht prej situatës së caktuar.³³ Organizata ekstremiste nuk e kufizojnë pjesëmarrjen në formacionet e tyre në bazë gjinore dhe së këndejmi për to janë të mirseardhur kushdo qoftë mashkull ose femër, në këtë drejtimi varësisht prej gjinisë atë u'a ndajnë edhe rolet atyre. Të dhëna të ndryshme na tregojnë se femrat të cilat janë të antarësuar apo edhe ato të cilat janë rrobëruara nga organizata ekstreme, kryesisht shfrytëzohen si skallve seksi, ndërsa meshkujt si ushtarë. Raste të vaçanta paraqesin sulmet vetëvrasëse, në këto raste shfrytëzohen edhe meshkujt edhe femrat për të arritur qëllimin final. Duhet theksuar se si meshkujt ashtu edhe femrat mund të bëhen viktimë e organizatës ekstremiste dhe të pësojnë, meshkujt në të shumtën e rasteve pësojnë me jetën e tyre ndërsa femrat me integritetin e tyre moral.³⁴

³¹ Shih në, <http://edition.cnn.com/2014/09/11/world/meast/isis-syria-iraq/>, publikuar më, 12.shtatorë.2014. i qasshëm më 1.mars.2017

³² Shih në, <https://en.zamanalwsl.net/news/15089.html>, publikuar më, 4.korrik.2017. i qasshëm më 1.mars.2017

³³ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.131

³⁴ Shih në, <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/5-ways-isis-terrorises-women-a6895581.html> publikuar më, 25.shkurt.2016. i qasshëm më 3.mars.2017

2.5. Gjendja martesore dhe statusi familjar

Zgjidhja e statusit familjar është një ndër elementet kryesore për një shoqëri të shëndosh andaj jo rastësisht familja llogaritet si bërthama e shoqërisë. Pjesëmarrësit në organizata të ndryshme ekstremiste kanë status familjar të ndryshëm edhe atë për nga numri në bazë të evidencave statistikore në rend të parë janë personat e pamartuar, në rend të dytë janë personat e martuar dhe më pas ato të shkurëzuar dhe të ve. Në këtë drejtim mund të thuhet se personat e pamartuar nuk kanë të njejtën përgjegjësi sikurse ato të martuarit dhe më lehtë mund të bijen pre e ndikimive nga jashtë dhe në këtë mënyrë të bëhen pjesë e organizatave të ndryshme ekstremiste, megjithatë edhe numri i personave të martuar që ju bashkangjiten organizatave ekstreme nuk është i vogël. Tek të shkurëzuarit dhe të vetë, motiv ose shkas mund të jetë dëshira e madhe për tu hakmarrë dhe kështu organizatat ekstremiste duke shfrytëzuar këtë gjendje të tyre, i ngërthejnë ato në gjirin e vet. ISIS si organizata më e madhe ekstremiste ka këtë strukturë për sa i përket statusit familjar: 69,5 % beqar, në këtë përqindje janë të përfshirë edhe të shkurëzuarit dhe të vetë dhe 30,5% të martuar.³⁵

2.6. Gjendja sociale- statusi social

Statusi social luan rol shumë të rëndësishëm se në çfarë drejtimi do ti orientoj sjelljet e tij individi, historikisht nga të dhënat kriminologjike sjelljet kriminale u janë adresuar shtresave të ulta ose është llogaritur si karakteristik e këtyre shtresave sidomos për kategorinë e punëtorëve njerëzve të papunë dhe të varfur, e gjithë kjo e bazuar në numrin e personave ndaj të cilëve janë ngritur kallzime penale, aktakuza dhe u janë shqiptuar dënime nga ana e gjykatës. Shqetësuese është situata lidhur me sjelljet kriminale shumë të rrezikshme e pak të dënushme nga organet kompetente, pra lidhur me kriminalitetin e „jakës së bardhë” respektivisht kriminalitetin e pushtetit apo personave të rëndësishëm në shoqëri. Realitet është se prirje për krim kanë të gjitha shtresat e shoqërisë pa dallim në statusin social, ato dallojnë vetëm për nga motivet e kryerjes së sjelljes kriminale dhe kështu nuk duhet etiketuar krimin si një karakteristik e një shtrese të caktuar.³⁶ Gjendja sociale nuk ka ndonjë rëndësi të veçant për ata të cilët duan të ekstremizojnë sa më shumë njerëz, mirëpo gjendja sociale në të cilën ndodhen ato njerëz mund të shfrytëzohet për qëllime të caktuara, p.sh. për të ekstremizuar një person të shtresës së ulët mund të manipulohet duke shfrytëzuar gjendjen e tij dhe duke i premtuar se me antarësim në organizatë me tipare ekstreme problemet e tij financiare do të marrin fund dhe e kundërta nëse dëshirohet të ekstremizohet ndonjë person i pasur, si metod e përdorur është që ai me pasurinë e tij të kontriboj në kauzën e „madhe”, raste si shembulli i fundit janë të njohura në qytetin e Gostivarit, ku persona me gjendje financiare shumë të mirë kanë përfundur në organizata ekstreme siç është ISIS.

³⁵ Shih në, <https://en.zamanalwsl.net/news/15089.html>, publikuar më 4.korrik.2016, i qasshëm më 3.mars.2017

³⁶ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.133

2.7. Të dhëna themelore për organizatën më ekstreme në botë, ISIS

ISIS, i ashtuquajtur shteti islamik në Siri dhe Irak është organizata ekstremiste më diskutabile në botë. Për të pasqyruar të dhëna themelore lidhur me këtë organizatë duhet sqaruar dhe përgjigjur një sërë pyetjesh, duke filluar nga ajo më kryesorja. Si u formua një organizatë e këtillë me tipare ekstremiste dhe terroriste?! Dhe më pas vijoin pyetjet: A ka diçka të përbashkët me fenë Islame edhe pse emërtohet si shtet islamik?! Si arriti dhe arrinë të rekrutoj aq shumë njerëz?! Si arriti të siguroj aq shumë finansa?! Si arriti të pushtoj aq shumë territore?! dhe pyetja më diskutabile, Si arrijnë të mbijetoj kur e tërë „bota ” po e lufton?! Duke sqaruar dhe përgjigjur këtë pyetje do të pajisemi me njohuri themelore lidhur me organizatën më ekstreme në botë.

Mënyra e krijimit të ISIS paraqitet me shumë labirinte dhe kështu që paraqiten disa variante të mundshme. Polemika më e madhe është ngritur nga ana e Presidentit të sapozgjedhur të SHBA-ve Donald Trump i cili në kampanjën parazgjedhore akuzoi ish Presidentin Barack Obama si themelues të ISIS ndërsa Hillary Clinton si bashkëthemeluese. Akuzat e tij konsistojnë në politikat e gabuara të kabinetit Obama në Irak dhe si rezultat i këtyre politikave të gabuara ka ardhur deri në formimin e ISIS.³⁷ Variant tjetër është se ISIS është krijuar në një burg amerikan në Irak, më saktësisht si vendlindje e ISIS llogaritet „Camp Bucca” në Irak, pasi që këtu në këtë burg kanë vuajtur dënimin 9-nëntë anëtar të komandës së lartë të ISIS përfshi këtu edhe kreun e saj Abu Bakar Al-Baghdadi.³⁸ Kësaj variante i shtohet edhe intervista e një pjesëtari të ISIS, Abu Ahmed për britaniken „The guardian” dhe fotoja e senatorit John McCain me kreun e ISIS.³⁹ Megjithatë si variant më i pranuar në opinion mbetet se ISIS u krijua si rezultat i shkëputjes së një pjese të Al-qaedas dhe krijimit të një formacioni të rij ekstremist terrorist, i cili tashmë tmerron jo vetëm territoret në të cilët ka shtrirje por edhe botën në përgjithësi.⁴⁰ Pas kësaj duhet sqaruar dhe përgjigjur se a ka diçka të përbashkët ISIS me fenë Islame edhe pse shtetet e identifikojnë si i ashtuquajtur shtet islamik. Ky term nuk është aspak i duhur dhe i përshtatshëm mirëpo arsyetohet nga fakti se pjesëtarët e ISIS e identifikojnë veten me një emërtim të tillë, mirëpo për çdo musliman ky term nuk është i pranueshëm. Nuk është i pranuar pasi që ISIS nuk ka të bëjë aspak me fenë Islame. Normal kjo duhet argumentuar, të gjitha veprimet e ISIS janë në kundërshtim me parimet themelore fetare Islame. Fjala Islam do të thotë paqe, ndërsa ISIS është promotor i dhunës, më pas të gjitha veprimet e ISIS konsistojnë në dhunë, thirrje ose nxitje për

³⁷ Shih në, <http://www.oranews.tv/bota/trump-obama-eshte-themelues-i-isis-klinton-bashkethemeluese/>, publikuar më 11.tetor.2016. i qasshëm më 5.mars.2017

³⁸ Shih në, <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/camp-bucca-the-us-prison-that-became-the-birthplace-of-isis-9838905.html>, publikuar më, 4.nëntor.2014. i qasshëm më 5.mars.2017

³⁹ Shih në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/isis-u-krijua-ne-nje-burg-amerikan-146314/?archive=1>, publikuar më, 21.nëntor.2015. i qasshëm më 5.mars.2017

⁴⁰ Shih në, <http://lajmpress.com/si-nisi-lufta-civile-ne-siri-mes-qeverise-dhe-opozites/>, publikuar më, 17.nëntor.2015. i qasshëm më 5.mars.2017

të, kjo është në kundërshtim me disa ajete Kur'anore një ndër të cilët „ në fe nuk ka dhunë ”⁴¹ Poashtu jemi dëshmitar se nga shumë sulme të ISIS pësojnë njerëz të pafajshëm në këtë drejtim veprimet e tyre janë në kundërshtim me ajetin Kur'anor „ Ai i cili vret një njeri të pafajshëm është sikur ta ketë vrarë tërë njerëzimin”.⁴² Nga kjo konstatojmë se çdo gjë që është në kundërshtim me bazën e Islamit, Kur'anin nuk ka asgjë islame në të. Islami është sistem jete përplotë me vlera e jo me robëri e dhunë, ndërsa ISIS është thjeshtë një organizatë e qelbësirave të cilët duan të njëjlojnë dhe të krijojnë bindje të keqe ndaj një ndër feve më të përhapura në botë dhe me keqardhje duhet theksuar se deri diku ka arritur të krijojë këtë qëllim pasi që shumë shtete dhe njerëz kanë krijuar një averzion ndaj popullsisë me përkatësi fetare islame, e gjithë kjo si rezultat i dy gjërave së pari si rezultat i paftësisë të vet muslimanëve për tu mbrojtur nga sfidat e kohës dhe së dyti ndoshta dikush dëshiron të na identifikojë si proklamues së dhunës dhe më pas të na sulmojë. Andaj nga të gjithë këto ndodhi viktimat më të mëdha janë muslimanët.

Problemë të tjerë lidhur me ISIS është se si arriti të rekrutojë aq shumë njerëz! Sot pothuajse nga e gjithë bota ka pjestarë në formacionet e ISIS edhe atë nga Maqedonia sipas të dhënave ka rreth 110 luftëtarë në Siri dhe përveç tyre 25 janë të vrarë atje dhe 86 janë kthyer në R.M.,së.⁴³ Nga Kosova mbi 300 persona kanë shkuar në Siri⁴⁴, nga Shqipëria rreth 70 persona dhe në këtë drejtim duhet theksuar se prej vitit 2014 asnjë shtetas i Shqipërisë nuk i është bashkuar me ISIS.⁴⁵ Poashtu nga shumë vende evropiane ISIS ka pjestarë të saj edhe atë prej France 1200 pjestarë, prej Mbretërisë së Bashkuar 500-600, prej Gjermanie 500-600, prej Belgjike 440, prej Holande 200-250, prej Suedie 150-180, prej Danimarkë 100-150, prej Austrie 100-150, prej Spanje 50-100, prej Itale 80, prej Finlande 50-70, prej Norvegjie 60, prej Zvicre 40 dhe prej Islande 26 pjestarë si dhe prej shumë vendeve të tjera ISIS ka pjesëtarë në rrethin e saj, diku afërsisht 4000 ushtarë të huaj llogaritet të jenë nga viset perendimore. Mënyra e rekrutimit bëhet ose në mënyrë direkte ose përmes ndonjë kontakti indirekt dhe poashtu nëpërmjet propagandës në rrjete të ndryshme sociale.⁴⁶ Thirrësit për bashkangjitje në këtë organizatë, esencën e thirrjes e përqendrojnë në thirrjen për në „xhihad” respektivisht në „ luftën për Allah” dhe në këtë mënyrë ato arrijnë të rekrutojnë sa më shumë njerëz me ideologji të përbashkët por si kur e atyre. ISIS llogaritet organizata ekstremiste terroriste me mjete financiare më të mëdha se të gjitha organizatat e tjera, finansat kryesisht i siguron përmes këmbimit të pengjeve në kundërvlerë me mjete financiare, kontrabandës së naftës si dhe poashtu në territoret që i zotëron ka të vendosur sistem tatimor, ku të gjithë qytetarët të cilët jetojnë në ato pjesë janë

⁴¹ Kur'an, Suretu El Bekare, ajeti ,256

⁴² Kur'an, Suretu Maide, ajeti, 32


⁴³ K.Selimi & F.Stojkovski, "Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm pikëpamje nga shoqëria civile", fq.10

⁴⁴ Shih në, <http://www.mia.mk/sq/Inside/RenderSingleNews/299/132923450> , publikuar më 2.dhjetor.2015. i qasshëm më 7.mars.2017

⁴⁵ Shih në, <http://telegrafi.com/shqiperia-perballet-rrezikun-e-xhihadisteve-ne-hije-foto/> , publikuar më 23.mars.2016, i qasshëm më 7.mars.2017

⁴⁶ Sara Zeiger & Anne Aly, Countering violent extremism: Developing an evidence-base for policy and practice, Hedayah and Curtin University, Australia, 2015, p.13

të obliguar të paguajnë tatim.⁴⁷ ISIS që nga themelimi i tij e deri më sot ka arritur të marrë nën kontroll një pjesë të madhe të territorit në Siri dhe Irak, andaj jo rastësisht e llogarit veten si shtet pasi që plotëson kushtet themelore të një shteti siç janë territori, popullsia dhe sovraniteti, mirëpo dy elementet tjera poashtu shumë të rëndësishme si njohja e shtetit dhe aftësia për të hyrë në marrdhënie ndërkombëtare do ti mungojnë gjithnjë edhe pse shumica e shteteve i drejtohen me termin „i ashtuquajtur i shteti islamik ” që de facto len një zbraztirë dyshimi. Termi shtet në emërtimin e kësaj organizate nuk duhet përmendur aspak sepse kemi të bëjmë me një organizatë të dhunshme ekstremiste e jo me një shtet konkret, përdorimi i këtij emëritimi është i dëmshëm pasi që në një mënyrë i vë nën hije autoritetet legjitime të atyre territoreve.



Territori nën kontroll të ISIS.⁴⁸

Befasia më e madhe është se si ISIS arrinë të mbijetoj kur e gjithë „bota” po e lufton respektivisht është kundër saj. Dilema se mos vallë dikush nga superfuqitë botërore qëndron pas kësaj organizate për interesa të ndryshme gjeostrategjike mund të shuhet vetëm atëher kur do të pushoj së ekzistuari kjo organizatë ekstremiste, në të kundërtën kjo është në kundërshtim me realitetin pasi që nëse në të vërtetë e gjithë bota do e luftonte kjo organizatë e dhunshme ekstremiste që moti do të kishte pushuar së ekzistuari. Andaj, mund të thuhet se ISIS është rezultat i interesave të kundërta përkatësisht konflikt interesave të superfuqive të cilat të gjitha ngjarjet i zhvillojnë në vende të treta. Kontributi korrekt dhe i sinqert e jomanipulativ i të gjithë shteteve në mënyrë të patjetërsushme dërgon në eliminimin e ISIS, në momentin që do të ndodhë kjo, ISIS nuk do të ekzistoj.

⁴⁷ Shih në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ja-sa-para-ka-is-152679/?archive=1> , publikuar më 17.dhjetor.2015. i qasshëm më 7.mars.2017

⁴⁸ Shih në, <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-27838034> , publikuar më 20.janarë.2017, i qasshëm më 7.mars.2017

III. Shkaqet e ekstremizmit të dhunshëm

3.1. Ideologjia shkak i ekstremizmit të dhunshëm

Çdo fenomen ka karakteristikat themleore dhe të veçanta të cilat shpiejn në të, kësisoj deri te fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm mund të vijm si rezultat i disa faktorëve apo shkaqeve. Si shkaqe të cilat na shpiejn në ekstremizmin e dhunshëm llogariten: Ideologjia problemet ekonomike, lufta, institucionet penitensiare, mediat kanë një rolë të veçant, shkalla e arsimimit, familja, rrethi si dhe shoqëria në përgjithësi. Ideologjia llogaritet si shkak kryesor i ekstremizmit të dhunshëm me pretekste fetare megjithatë ajo poashtu llogaritet edhe si shkak i llojeve të tjera të ekstremizmave, andaj jo rastësisht individët ose grupacionet e ekstremizuara përmes dhunës dëshirojnë të arrijnë ndryshime ideologjike, politike apo religjioze. Individët apo grupacionet e ndryshme të ekstremizuara duke përdorur një ideologji të caktuar tentojnë që ti arsyetojnë veprimet e tyre të dhunshme respektivisht pikë motivimi në veprimtarin e tyre të dhunshme llogarisin ideologjinë.

Ideologjia llogaritet si sistem i ideve dhe besimeve të cilat orientojnë për të kuptuar realitetin dhe veprimtari në shoqërore. Të gjitha ideologjitë përshkruajnë sistemin ekzistues modelojnë të ardhmen dhe tregojn si mund dhe si duhet të bëhet ndryshimi i caktuar kryesisht ai politik. Pakënaqësit e shumta në shoqëri si rezultat i interepreimit të interesave të një pjese të caktuar si interesa të përgjithshme dhe universale shpijen në ekstremizëm që në të shumtën e rasteve për të arritur një ndryshim të caktuar në këtë drejtim përdoret dhuna (ideologjia e terrorit).⁴⁹ Ndërlidhja e individëve apo grupacioneve të ndryshme ekstreme që kryejn veprimtari të dhunshme me ndonjë religjion apo sistem të caktuar është gabimi më i madh që bëhet në këtë drejtim. Gabim, pasi që religjioni apo ndonjë përkatësi tjetër nuk nënkupton arsyetim të veprimtarisë së dhunshme, andaj çdokush që kryen veprimtari të dhunshme duhet të gjykohet individualisht ose si grupacion, e jo si proklamues apo pjesëtar i një religjioni, kulture, kombi apo race konkrete. Me fjaë të tjera të gjithë ato të cilët kryejnë veprimtari të dhunshme duhet identifikuar si individ apo grupacione të dhunshme, terroriste, të radikalizuar, e jo si islamist hebrej, të krishter, nacionalist, marksist, anarkist, demokrat e të tjerë, të cilët dëshirojnë të fshihen për të arsyetuar veprimtarin e dhunshme. Në këtë drejtim sot, padrejtësia më e madhe i bëhet komunitetit musliman pasi që me veprimtarinë e dhunshme të organizatës ekstremiste terroriste ISIS, disa vende dhe shtete dëshirojnë të identifikojnë të gjithë muslimanët respektivisht paraqesin veprimtarinë e tyre si veprimtari e të gjithë muslimanëve që është krejtësisht gabim dhe e papranueshme për çdonjë musliman dhe si rezultat i kësaj sot në opinion kemi të njohur termin „terrorizëm islamik” që është krejtësisht i papranueshëm. Duke filluar nga ideologjitë fundamentaliste të religjioneve dhe trajtimin edhe të ideologjive të tjera do të shqyrtojm të gjitha

⁴⁹ Shih në, <http://shenja.tv/ideologjia-e-terrorit/>, shkruan: Latif Mustafa, publikuar më 4.janar.2016, i qasshëm më 13.mars.2017

lidhshmëritë e tyre me ekstremizmin e dhunshëm dhe sqarimi i të gjitha dilemave do të na mundësoj të bëjmë dallimin e duhur midis ekstremizmit të dhunshëm dhe ideologjive konkrete.

Historikisht brenda çdo religjioni kanë ekzistuar dhe ekzistojnë rryma fundamentalist radikale dhe ekstreme, mirëpo se sa ato janë interpretues të drejtë të një religjioni të caktuar është krejtësisht çështje tjetër. Çdo religjion është shumë më i madh se sa një individ apo grupacion që dëshiron ta proklamojë atë religjion, si të dhunshëm dhe të papranueshëm në shoqëri. Në suaza të besimit Islam kanë ekzistuar dhe ekzistojnë individ dhe grupacione sektare të cilët thirren në Islam e që në realitet nuk kanë asgjë të përbashkët me besimin islam dhe që me veprimtarinë e tyre i ekstremizojnë gjërat dhe në këtë drejtim në disa raste bëjnë thirrje, nxisin apo përdorin dhunë për të realizuar ndonjë qëllim të caktuar. Hashashinët (asasinët) e shekullit XI njihen si ekstremistët e parë në suaza të besimit Islam, poashtu është e njohur veprimtaria ekstreme shijite dhe në periudhën më të vonshme si grupacione ekstreme njihen Al Qaeda, Al Nusra, Boko Haram, ISIS.⁵⁰ Veprimtaria e dhunshme e të gjithë këtyre grupacioneve arsyetohet në ideologji ekstreme mirëpo bazë islame nuk ka aspak. Të gjitha këto grupacione bëjnë manipulime me njerëz tek të cilët lehtë mund të ndikohet duke prekur ndjenjat e tyre fetare. Grupacionet ekstreme për të realizuar interesat e tyre bëjnë thirrje për në „Xhihad” që tekstualisht do të thotë „luftë” respektivisht në besimin Islam ka kuptimin e luftës në rrugë të Allahut dhe në këtë drejtim sigurimin e parajsës, synimit të çdo muslimani. Andaj duke bërë manipulime të tilla ato rekrutojnë sa më shumë njerëz për të vetmin qëllim, realizmin e interesave të tyre e jo kënaqjen e Allahut me veprimtarinë e tyre. Veprimet ekstreme të dhunshme të disa grupacioneve të cilat veprojnë jashtë ligjit islam mund të llogariten luftë, por jo edhe xhihad sipas besimit islam tradicional. Kështu që jo çdo luftë është Xhihad dhe jo çdo Xhihad është luftë”.⁵¹ Fatkeqsisht nga veprimtaria e dhunshme e disa individëve dhe grupacioneve të cilët dëshirojnë ta proklamojnë Islamin si Fe të dhunshme sot me qindramijëra musliman janë të vrarë, miliona të tjerë janë obliguar që të lëshojn vendbanimet e tyre kryesisht nga zonat e krizës Siri, Irak, Afganistan dhe krahas kësaj në përgjithësi është duke u krijuar dhe ushqyer një bindje negative për mbarë muslimanët e botës dhe llogaritja e tyre si terrorist ekstremist potencial. Kjo e fundit argumentohet edhe me dekretin e presidentit të SHBA-ve Donald Trump për ndalimin e hyrjes në territorin e Amerikës të qytetarëve kryesisht nga shtetet me përkatësi fetare Islame me arsyetim të ruajtjes së sigurisë së shtetit dhe qytetarëve të tij, poashtu edhe me një sërë sulmesh ndaj njerëzve në veçanti grave me mbulesë si dhe një sërë sulmesh nëpër xhamitë në vendet evropiane si dhe në shumë vende tjera si SHBA, Kanadë etj. Pasojat e dëmeve që i shkakton një grupacion i vogël ekstrem i cili vepron jashta çdo norme Islame, e paguajnë mbi 1-një miliardë e gjysmë musliman, a është kjo rastësisht apo tendencioze mbetet të shihet në të ardhmen. Konstatim i përgjithshëm është se ato të cilët thiren në ideologji ekstreme islame i bëjnë dëm besimit islam më shumë se kushdo tjetër, besimi Islam ka ardhur për të u’la lehtësuar punën

⁵⁰ F.Kamberi, Fundamentalizmi i religjioneve të mëdha monotesite dhe globalizmi, Prishtinë, 2015, fq.160-169.

⁵¹ GH.Muhammad, I.Kalin, M.Kamali, Lufta dhe paqja në Islam: përdorimet dhe abuzimet me xhihadin, Tiranë, 2015, fq.116-118. Titulli origjinal, War and peace in Islam: The uses and abuses of Jihad, MABDA, Jordan, 2013.

individit në veçanti dhe shoqërisë në përgjithësi, e jo për të vështirësuar e për të ekstremizuar jetën e tyre. Ata të cilët kanë sadopak njohuri në lidhje me besimin Islam e kanë të qartë se në të nuk ka asgjë ekstreme, por vlera, liri dhe barazi për të gjithë pa asnjë dallim.

Edhe në kuadër të religjioneve të tjera ekzistojnë grupacione të cilat veprimet e tyre të dhunshme dëshirojnë ti arsyetojnë mbi baza të ndonjë religjioni konkret. Ekstremistët e krishter pretendojnë që veprimet e tyre të dhunshme ti arsyetojnë në interpretimet e gabueshme që i bëjnë biblës dhe në këtë mënyrë duke përdorur Dhjatën e Vjetër dhe shkrimet e Dhjatës së Re dhe duke kërkuar fundin e botës që përshkruhet në shkrimet e Dhjatës së Re, të njëjtit duan ti arsyetojnë vrasjet, dhunën, thirrjen apo nxitjen për të me qëllim të realizimit të ndonjë interesi të ngushtë.⁵² Si organizatë ekstreme e krishtertë më e njohur është Kju-Klus-Klan që ka vepruar në SHBA, të cilët kryesisht duke u bazuar në ideologji ekstreme të krishtere normal sipas pretendimeve të tyre, kanë arsyetuar vrasjet, plaçkitjet, dhunën ndaj afro-amerikanëve, hebrenjëve si dhe të tjerëve me arsyetimin e rivendosjes së vlerave të krishtera protestante në Amerikë dhe poashtu besonin se Jezusi (Isa a.s.) ishte anëtar i parë i këtij klani. Ekzistojnë edhe shumë organizata ekstreme të krishtera përveç Kju-Klus-Klanit edhe atë: Partia Knights në SHBA, Kombet ariane, Ushtria e Perendisë, Besëlidhja, Shpata dhe krahu i Zotit, etj.⁵³ Poashtu edhe në kuadër të hebrenjizmit ekzistojnë individë dhe grupe ekstreme dhe radikale. Ekstremistët hebrenjë sot më tepër insistojnë në dëbimin e pjestarëve musliman nga xhamia e shenjtë Al-Aksa dhe në këtë drejtim ato arsyetojnë veprimet e tyre të dhunshme duke u bazuar në atë se i njëjti objekt ka rëndësi fetare edhe në besimin e tyre. Historikisht janë të njohur disa grupacione ekstreme me përkatësi fetare hebreje, si: Brit HaKan, Gush Emun Underground, Grupi i Mbretërisë së Izraelit, etj.⁵⁴ Ekstremizmi i dhunshëm i bazuar në ideologji ekstreme fetare ekziston edhe në religjionet politesite siç janë hinduizmi dhe budizmi. Janë të njohura disa ngjarje të cilat kanë nxjerr në pah ekstremizmin e këtillë, është e njohur se një besimtar hindu ishte ai që vrau Mahatma Ghandin dhe që atëherë dhuna në mes hindusëve dhe muslimanëve ka qenë endimike në Indi. Brenda besimit budistët ka poashtu formacione ekstremiste edhe atë në këtë drejtim janë të njohura ngjarjet në Shri Lankë, ku grupet budiste Sinhala kanë kryer dhe kanë urdhëruar dhunë kundër Tamilëve dhe të krishterëve poashtu mund të konstatohet se sot në Myanmar po kryhet gjenocid ndaj pjestarëve musliman nga Lëvizja budiste 969 me ndihmë edhe të autoriteteve, nën arsyetimin e një ideologjie ekstreme budiste.⁵⁵ Veprimet ekstremiste të dhunshme janë mbështetur dhe arsyetuar edhe në ideologji të ndryshme politike. Historia na mëson se shumë autoritete në ushtrimin e funksioneve të tyre kanë mbështetur dhe ushtruar dhunën me të vetmin qëllim, arritjen e interesave politike. Është e njohur ideologjia ekstreme nacionaliste e Adolf Hitlerit, ideologjia fashiste e Benito Muselinit, ideologjia marksiste, anarkiste, komunizmi, të gjitha këto ideologji në raste të caktuara sipas situatës së paraqitur kanë mbështetur, kanë nxitë,

⁵² B.Hoffman, Inside Terrorism, Columbia University Press, 1999, p.105-120.

⁵³ F.Kamberi, Fundamentalizmi i religjioneve të mëdha monotesite dhe globalizmi, Prishtinë, 2015, fq.158-160

⁵⁴ Po aty, fq.157-158

⁵⁵ Po aty, fq.155-157

thirrë apo përdorur dhunë për realizimin e interesave politike.⁵⁶ Demokracia është koncepti politik aktual dhe mund të thuhet si më i pranueshmi në shoqëri. Problematika kryesore shfaqet në atë se formacione të ndryshme ekstreme duke u thirrur në vlerat demokratike të këtij sistemi në shumë raste bëjnë thirrje, nxisin apo përdorin dhunë për të arritur ndonjë qëllim të caktuar kryesisht politik dhe arsyetojnë të njëjtat nën pretekstin se në demokraci gjithëçka është e lejuar. Pra duke keqpërdorur vlerat demokratike tentojnë të mbjellin urrejte dhe të nxisin dhunë dhe të shpërfaqin në sipërfaqe atë të cilën në realitet e kanë të ngulitur në brendësinë e tyre. Ideologjia në një formë mund të paraqitet si burim i ekstremizmit të dhunshëm, mirëpo në asnjë mënyrë edhe arsyetimi i tij. Dhuna nuk mund të arsyetohet, por duhet të parandalohet ose të ndëshkohet.

3.2. Problemet ekonomike dhe ekstremizmi i dhunshëm

Krahas shumë problematikave të cilat shfaqen në përditshmëri si probleme kryesore me të cilat ballafaqohet njerëzimi në përgjithësi, janë problemet ekonomike dhe ato të sigurisë. Problemet ekonomike shfaqen si faktorë kyç në paraqitjen e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm por jo vetëm. Klasifikimi në lidhje me atë se problemet ekonomike mund të shfaqen si faktorë të ekstremizmit jo të dhunshëm dhe të dhunshëm është adekuat dhe real. Krizat ekonomike papunësia, varfëria, kushtet e vështira të banimit llogariten si shkaqe shumë të rëndësishme në marrjen e vendimeve që në esencë përmbajnë ekstremizëm por jo në të gjitha rastet atë të dhunshëm edhe pse problemet ekonomike janë në një linjë me rritjen e kriminalitetit dhe dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm. Rastet konkrete që përmbajnë në vete vendime ekstreme jo të dhunshme si rezultat i problemeve të shumta ekonomike paraqet dukuria e braktisjes së vendit kryesisht nga të rinjtë por edhe nga të gjithë grupmoshat në përgjithësi. Për të siguruar një vend pune, për të evituar varfërinë dhe kushtet e vështira të banimit, për të siguruar ekzistencën respektivisht për të siguruar të gjitha kushtet e nevojshme për një jetë dinjitoze dhe me integritet të plotë moral dhe familjar, sot shumë të rinjë por edhe grupmosha të tjera braktisin R.M.,së dhe drejtohen në vende të zhvilluara ekonomikisht për të siguruar të njëjtat. Kjo dukuri është e shprehur edhe në shtete të tjera të rajonit dhe shtete ku varfëria dhe numri i papunësisë është shumë e theksuar. Ky vendim për të lënë pas gjithëçka dhe për të filluar një jetë të re në një vend tjetër në vete përmban një dozë ekstremizmi që ska të bëjë me dhunën, por me faktorët ekonomik si shtytës për të marrë vendime të ndryshme, e gjithë kjo si rezultat i keq menaxhimit të politikave ekonomike nga ana e pushtetit. Ndarja e fondeve shtetërore për gjëra të pavlefshme si buste dhe statuja të ndryshme, e jo për zhvillim ekonomik, krijimin e sa më shumë vendeve të punës, motivimin e të rinjëve për të dëshmuar aftësi të tyre të fituara në sfera të ndryshme, vënia

⁵⁶ Shih në, <http://www.gazetaimpakt.com/lajm/7828/cfare-eshte-fashizmi/>, publikuar më 11.maj.2016, <http://www.tiranaobserver.al/terrori-dhe-propaganda-naziste-gjermane-si-shembull-per-terrorin-dhe-propaganden-komuniste-shqiptare/>, publikuar më 19.nëntor.2014, <https://educatealbania.wordpress.com/2014/10/09/marksizmi-marxism/>, publikuar më 9.tetor.2014, të gjithë këto artikuj të qasëm më 18.mars.2017

në funksione e tyre në dobi të shoqërisë, sigurimit të një jete normale për çdo individ dhe familje, e shumë e shumë mundësive të tjera për dobi të përgjithshme, për fat të keq ka sjell në këtë situatë të braktisjes së vendit e cila është shumë vështirë të ndalohej, pasi që parandalimi i së njejtës është pamundësuar që moti.

Krizat ekonomike, papunësia, varfëria, kushtet e vështira të jetesës kryesisht në bazë të të dhënave empirike kriminologjike janë të lidhura më shumë me kryerjen e krimeve të ndryshme pa përjashtuar edhe lidhshmërinë me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm. Në raste të krizave ekonomike vjen deri te lëshimi nga puna i punëtorëve, shtrejtimi i të mirave materiale, ngecja e prodhimit dhe një sërë problemesh të tjera shoqërore dhe si rezultat i kësaj ndodhin ngjarje të cilat vështirësojnë ekzistencën e popullsisë. Për ndikimin e problemeve ekonomike në paraqitjen e dukurive negative, Aristoteli ka thënë „varfëria është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit”. Në kohë krizash ekonomike si krime më të theksuara paraqiten: vjedhjet, grabitjet, bixhozi, prostitucioni, mashtrimet, abuzimet, tregtia e palejuar, etj.⁵⁷ Problemet e shumta ekonomike mund të jenë faktor shtytës i individit apo ndonjë grupacioni në veprime ekstreme të dhunshme. Organizatat e ndryshme ekstremiste si pjesë e strategjisë për rekrutim të sa më shumë individëve, në mënyrë të patjetërsueshme kanë edhe hulumtimin e pozitës së caktuar ekonomike të individit apo grupacionit që është cak i rekrutimit. Për të menjanuar përgjegjësin përkatsisht për të evituar problemet e vështira socio-ekonomike shumë njerëz zgjedhin antarësimin në organizata ekstreme si mënyrë apo mundësi e krijuar për tu shmangur nga realiteti, duke u munduar të mbyllin një problematik i shtojn vetes, familjes, rrethit më të gjërë dhe gjithë shoqërisë probleme më të mëdha.⁵⁸ Poashtu shumë individ apo grupacione duke u bazuar në premtime të karakterit të menjanimit të problemeve ekonomike ose arritjes së qëllimeve të caktuara bijen pre e formacioneve të ndryshme ekstremiste dhe terroriste, shembull konkret janë pjestarët e klerikut Fetullah Gylen i cili duke shfrytëzuar pasurinë e tij ka rekrutuar një sërë njerëzish dhe ka krijuar një strukturë paralele në turqi me qëllim të arritjes së ndryshimit politik atje, e gjithë kjo me anë të dhunës respektivisht kryerjes së grushtetit si mënyrë e dhunshme e arrdhjes në pushtetit më 16 korrik 2016 e që e njehta dështoj.⁵⁹ Thënia e Adolf Hitleri-it se „sundimi i forcës e vë nën hije sundimin e së drejtës” sot ndryshohet me atë se „ sundimi i ekonomisë vë nën hije njerëzimin”. Sikur bota përkatësisht shtetet e fuqishme ekonomike të invenstonin në punë të dobishme për shoqërinë, aq sa investojnë në ushtri dhe mjete tjera të cilët cënojnë sigurinë dhe mirëqenien në përgjithësi, si ndërtimi i centraleve bërthamore krijimi i aparaturave të ndryshme të sotisfikuara për luftë dhe gjëra të tjera të ngjajshme, padyshim që sot njerëzimi do të jetonte në një harmoni të plotë larg të gjitha dukurive dhe veseve negative të cilat na shfaqen çdo ditë e më shumë. Një ndër garantuesit e paqes dhe menjanimit të dukurive negative në shoqëri siç është edhe ekstremizmi i dhunshëm është miërqenia ekonomike.

⁵⁷ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.241-248

⁵⁸ Shih në, <https://www.theatlantic.com/international/archive/2015/09/isis-territory-taxes-recruitment-syria/403426/> publikuar më 2.shtator.2015, i qasshëm më 27.mars.2017

⁵⁹ Shih në, <http://www.drita.tv/?p=20045> publikuar më 16.korrik.2016, i qasshëm më 27.mars,2017

3.3. Lufta dhe ndikimi i saj në ekstremizmin e dhunshëm

Lidhshmëria e ekstremizmit të dhunshëm me luftën është shumë e qartë dhe evidente, që të dyja këto qoftë si terme apo si koncepte karakterizohen me dhunën. Lufta paraqet një ngjarje politko-shoqërore që konsiston në ballafaqimin e armatosur e të dhunshëm mes popujve, kombeve apo shteteve midis dy apo më shumë palëve kundërshtarë brenda ose jashtë kufijve të një vendi respektivisht shteti. Në bazë të të dhënave historike kemi njohuri se në periudha të ndryshme kohore kanë ndodhur luftra të ndryshme, përfshirë këtu edhe dy luftërat botërore. Shkaqet që shtyejnë në luftë nga shumë autorë klasifikohen në mënyra të ndryshme, madje ekziston bindja se lufta është rezultat i pamundësisë së arritjes së zgjidhjes në mënyrë paqësore respektivisht kur e njëjta dështon në mënyrë paqësore, megjithatë si shkaqe të përgjithshme llogariten synimet territorial, vënia nën kontrollë e burimeve natyrore që i takojnë dikujt tjetër, konfliktet kulturore, dëshira për ndryshime politike, ideologjike apo fetare e shumë shkaqe të tjera.⁶⁰ Vlen të theksohet se lidhshmëria në mes të këtyre dy dukurive negative del në pah pikërisht në qëllimin që synohet të arrihet përmes kësaj veprimtarie të dhunshme, përkatësisht arritjes së ndryshimeve kryesisht të karakterit politike përmes dhunës. Llogaritet se vendi në të cilën zhvillohet luftë minimum 20-njëzet vite mbetet pas vendeve të tjera që d.m.th. pasojat e luftës janë shumë të mëdha qoftë në viktima në njerëz apo edhe në dëme materiale, rrimëkëmbja e të cilave kërkon shumë kohë dhe mund, megjithatë në qoftë se vihet një paralele me pasojat e ekstremizmit të dhunshëm vërehet se edhe kjo dukuri shkakton dëme shumë më të mëdha pasi që e njëjta nuk njeh vend apo kufij, por qëllimi i këtyre perosnave është të shkaktojnë dëme në çdo kohë, në çdo vend aty ku u jepet mundësia. Lidhshmëria e këtyre dy dukurive poashtu vërehet edhe nëpërmjet mundësive apo kushteve që u krijon lufta formacioneve të ndryshme ekstreme pasi që në kohë lufte shumë gjëra janë jashtë kontrollit dhe në këtë mënyrë kjo situatë e krijuar shfrytëzohet nga qarqe të ndryshme dhe si rezultat i kësaj paraqiten formacione të ndryshme ekstremiste, shembull kemi nga luftrat që janë zhvilluar dhe po zhvillohen në shtetet e lindjes së mesme kanë dalur një sërë grupesh ekstremiste terroriste të dhunshëm të cilat sot po terrorizojnë çdo vend të botës si ISIS, Al-Qaeda, Al-Nusra e shumë formacione të tjera. Nga kjo lidhshmëri e tyre mund të konkludojmë se lufta ka ndikim direkt në paraqitjen e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm përkatësisht paraqet një ndër shkaqet kryesore të shfaqjes së saj dhe në këtë mënyrë dëmet që shkaktohen nga këto dukuri i pëson e gjithë shoqëria. Përkundër shumë lidhshmërive, këto dukuri në mes veti kanë edhe shumë dallime duke filluar që nga mënyrë e veprimit të tyre. Lufta fillohet dhe zhvillohet nga dy apo më shumë palë të cilat kanë konflikt interesash dhe është e njohur botërisht se kush me cilën është në luftë, ndërsa tek ekstremizmi i dhunshëm kjo gjë nuk është e njohur, andaj në këtë mënyrë ekstremistët e dhunshëm zhvillojnë një „luftë” kundër të gjithë atyre të cilët nuk janë të mendimit të tyre apo me fjalë të tjera „lufta” e ekstremizmit të dhunshëm është një kundër të gjithëve. Një në kuptimin e asaj se ekstremistët në një anë, ndërsa të gjithë të tjerët në anë të kundërt.

⁶⁰ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.257-259

3.4. Burgu „vatër” e ekstremizmit të individëve

Dilema se si burgu ndikon në dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm respektivisht në ekstremizimin e individëve buron nga dyshimet e mënyrës së krijimit të organizatës ekstremiste terroriste më të rezikshme në botë ISIS. Burgu famëkeq në Irak „Camp Bucca” llogaritet si „vatër” e krijimit të ISIS, kjo dilemë ekziston pasi në të kanë vuajtur dënim ekstremistë më të rrezikshëm të këtij formacioni përfshiër edhe kreun e këtij grupi dhe të njëjtët sot po terrorizojnë njerëzimin në përgjithësi pa dallim feje, kombi, race apo ndonjë përkatësie tjetër.⁶¹ Çdonjëri i cili kryen ndonjë vepër të kundërligjshme e cila si e tillë është paraparë me ligj, do të ndëshkohet me sanksione adekuate për atë vepër. Kusht që një individ apo disa persona (rastet e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale) të përfundojnë në burg është që paraprakisht të ketë apo të kenë kryer ndonjë sjellje kriminale respektivisht vepër penale për të cilën parashihet dënim me burgim.⁶² Ekstremistët e dhunshëm shpesh të identifikuar edhe si terrorist në të shumtën e rasteve përfundojnë në burg si pasojë e krimeve të kryera, megjithatë duhet pasur parasysh se këto njerëz nuk janë kriminel tipik. Ajo që i dallon ato nga kriminelët e tjerë është qëllimi në kryerjen e sjelljes së kundërligjshme kriminale, e tërë veprimtaria e kundërligjshme e tyre është e drejtuar në arritjen e ndryshimeve të caktuara qofshin ato politike, ideologjike apo religjioze, që d.m.th. se veprat e tyre janë kryesisht të karakterit politik.⁶³ Ekstremistët e dhunshëm poashtu paraqesin sfidë për sistemin e burgjeve bashkëkohore sepse për trajtimin e tyre nevojitet një tretman i veçantë.

Burgu si institucion ndëshkues përmisues në bazë të të gjitha normave nacionale apo ndërkombëtare, poashtu edhe në bazë të shkencës së penologjisë (shkenca e cila meret me të drejtën e ekzekutimit të sanksioneve penale) ka për qëllim përmisimin, risocializmin, riedukimin dhe më pas riintegrimin e të gjithë atyre personave që kanë kryer sjellje devijante-kriminale, përkatësisht sjellje që janë në kundërshtim me interesat e shoqërisë.⁶⁴ Se sa në realitet realizohet qëllimi parësor që ka burgu është krejtësisht çështje tjetër, sot në shumë vende të botës ky institucion ka humbur qëllimin e tij dhe ndaj të burgosurve më shumë veprohet në mënyrë hakmarrëse se sa në drejtim të risocializimit të tyre dhe përmirësimit të sjelljeve të tyre në të ardhmen. Përpos në vendet e zhvilluara, në shumë vende kryesisht në ato të varfura dhe në tranzicion të burgosurit ballafaqohen me probleme esenciale respektivisht kanë mungesë në plotësimin e nevojave elementare, përfshirë këtu ushqim, veshmbathje, nxemje adekuate gjatë stinëve të ftohta, sistemim adekuat nëpër qeli dhe shumë problematika të tjera të ngjajshme të kësaj natyre. Kur i kemi gjithë këto probleme të theksuara, ku mbetet: tretmani adekuat për risocializim, riedukim dhe më pas riintegrimin e tyre në shoqëri apo krijimi i tretmanit adekuat

⁶¹ Shih në, <http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/camp-bucca-the-us-prison-that-became-the-birthplace-of-isis-9838905.html>, publikuar më 4.nëntor.2014, i qasshëm më 30.mars.2017

⁶² V.Kambovski, E drejta penale: pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq.123

⁶³ A.Slike, Prisons, Terrorism and Extremism, London & New York, 2014, p.3

⁶⁴ R.Halili, Penologjia: E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014, fq.95-100

për trajtimin e ekstremistëve të dhunshëm dhe terroristëve apo tretman adekuat për të kuptuar në mënyrë të duhur rrethanat që ndodhin në shoqëri.

Për fat të keq edhe në burgjet e R.M.së, në bazë të deklaratave të të ish burgosurve mund të kuptojmë se situata në to është alarmante. Në burgun e Idrizovës si më famëkeqi në Maqedoni ka mungesë të kushteve elementare, i njëjti është i mbipopulluar pasi në të vuajnë dënim mbi 2-dy mijë të burgosur ndërsa në realitet ka kapacitet për tetëqind persona dhe kjo gjendje nuk duhet shumë të sqarohet por mjafton vetëm vënia në funksion e logjikës, ndejtja e nga 8 personave në një qeli, mungesa e kushteve elementare, mosvënia në funksion e të burgosurve në punë të dobishme, sjellja jo humane dhe ushtrimi i torturës ndaj të burgosurve nënkuptohet se si mund të ndikoj në përmisimin e sjelljes së tyre në të ardhmen, çfarë është më e keqja se shumë persona kanë humbur edhe jetën në burg si rezultat i kushteve të vështira dhe intervenimit joadekuat dhe në kohë për ndihmë mjekësore.⁶⁵ Si rezultat i të gjithë këtyre diskriminimeve në institucionin i cili në realitet duhet të jetë shprehshëm për ta, në drejtim të përmisimit të gjendjes së tyre në të ardhmen dhe si rezultat i mosdhënies së ndihmës postpenale shumë të burgosur pas mbarimit të dënimit të tyre bijen preh e formacioneve të ndryshme radikale dhe ekstremiste. Mungesa e kushteve adekuate nëpër burgje lehtëson punën e formacioneve ekstremiste që kanë për qëllim të rekrutojnë sa më shumë njerëz. Franc Von List ka thënë „banuesit e burgjeve nuk e përbëjnë tërësinë e botës kriminale”. Nga kjo mund të kuptojmë se rreziku është shumë më i madh nga ato që veprojnë në liri ndërsa në mendjen e tyre kanë të ngulitur krimin dhe terrorizimin e shoqërisë.



Pamje nga burgu i Idrizovës.⁶⁶

⁶⁵ Shih në, <http://tv21.tv/web/?p=115447>, publikuar më 22.janarë.2017, i qasshëm më 31.mars.2017

⁶⁶ Shih në, <http://fokus.mk/idrizovo-zhenskiot-zatvor-pekol-za-zatvorenichkite/>, publikuar më 5.shkurt.2017, i qasshëm më 31.mars.2017

3.5. Roli i mediave dhe ndikimi i tyre në ekstremizmin e dhunshëm

Mediat apo mjetet e komunikimit masiv çdo ditë e më shumë po e risin rëndësinë apo ndikimin e tyre në çdo sferë të jetës shoqërore. Si mjete të komunikimit masiv apo të njohura edhe si masmedia konsiderohen: shtypi i përditshëm, shtypi javor, televizioni, radio, interneti, filmi, rrjetet sociale, etj. Në botën bashkëkohore jeta pa këto mjete pothuajse është e pamundur. Sot, televizori dhe rrjetet sociale kanë zënë një vend të veçantë në shoqëri në krahasim me mjetet e tjera të komunikimit, nuk ka shtëpi që nuk ka së paku një televizor dhe nuk ka ndonjë njeri sidomos grupmoshat e reja që nuk ka ndonjë faqe personale në rrjetet sociale. Është e njohur se nëpërmjet këtyre mjeteve të komunikimit opinioni i gjerë informohet me ngjarje të ndryshme të cilat ndodhin në një vend konkret apo në mbarë botën përkatësisht në nivel ndërkombëtar. Nëpërmjet këtyre mjeteve na mundësohet që të jemi më pranë ndodhive të cilat na tangojnë dhe për të cilat kemi dëshirë të kemi njohuri. Jo rastësisht zhvillohet një luftë e madhe për kontrollin, pushtetin dhe dominimin ndaj mediave të ndryshme, pasi që në të shumtën e rasteve opinioni gjërë orientohet nga ajo çka dëgjon apo çka sheh dhe lexon në ndonjë prej këtyre mjeteve të komunikimit dhe llogaritet se „ai i cili disponon me mediat, ai edhe qeveris një vend apo një shtet”.⁶⁷

Masmediat janë ato të cilat na mundësojnë që të kemi ndonjë parafytyrim të saktë apo të gabuar lidhur me ndonjë ngjarje apo ndodhi e cila ka ndodhur ose ndodhe në ndonjë vend apo shtet. Varësisht në çfarë drejtimi është adresuar interesi i medias së caktuar ashtu plasohet edhe lajmi në opinion dhe në këtë mënyrë ka raste kur informohemi drejtë apo edhe në mënyrë të gabuar për ndonjë ngjarje, kjo varet direkt nga qëllimi të cilën dëshiron ta arrijë ai që plasojë lajmin. Mediat kanë një rol të rëndësishëm në shoqëri nga se nëpërmjet tyre pranojmë shumicën e informatave, së këndejmi ato kanë një rol shumë të rëndësishëm edhe ndaj fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe mund të thuhet se mund të paraqiten edhe si faktorë kyç në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie dhe anasjelltas mund të jenë nxitës dhe shtytës shumë të fuqishëm të së njëjtës. Në kuadër të konferencave të shumta lidhur me analizimin e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm, theks të veçantë i kushtohet dukurisë së radikalizimit dhe rekrutimit nëpërmjet mediave online respektivisht nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale.⁶⁸ Duke plasuar në mjetet e informimit materiale të cilat në vete ngërthejnë ekstremizma të ndryshëm mundësohet që opinioni në mënyrë të drejtëpërdrejt të informohet me to. Grupacionet e ndryshme ekstremiste duke shfrytëzuar mediat të cilat i kanë nën kontroll dhe ato tek të cilat nuk ka ndonjë kontroll të përgjithshëm apo censurë, si rasti i rrjeteve sociale ku çdokush mund të nxjerr në faqen e tij çfarë të dëshiroj, shpërndajnë nëpërmjet tyre materiale të llojeve të ndryshme që shkojnë në interes të tyre. Shembull konkret, ISIS duke përdorur mënyra të ndryshme të qasjes në media shpërndan materiale propaganduese që shkojnë në favor të tyre. Rasti i njohur për popullsinë me përkatësi etnike shqiptare është rasti i Lavdrim Muhaxherit (një ndër ekstremistët më të kërkuar në botë), i

⁶⁷ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 262

⁶⁸ S. Zeiger, CVE RESEARCH BRIEF 3, Narratives and counter-narratives, Hedayah, December, 2014, p. 2

cili duke përdorur rrjetin social facebook poashtu edhe nëpërmjet video inçizimeve të shfaqura në youtube bëntë thirrje për bashkangjitje të të gjithë shqiptarve në të ashtuquajturën „luftë e shejnt apo xhihad” në tokat e lindjes së mesme. Në inçizimet e shfaqura nga ana e tij, ai rrëfen situatën e atjeshme si të përsosur dhe ëndërruese për çdo musliman dhe insiston me ngulm se të gjithë duhet të shkojnë dhe ti bashkohen asaj kauze dhe si rezultat i kësaj dhe shumë mënyrave të tjera propaganduese mediative, shumë shqiptarë ju bashkuan formacionit më ekstremist të dhunshëm siç është ISIS. Këtë metodë ISIS e përdor edhe ndaj etnive të tjera duke nxjer luftëtar të ndryshëm në media të ndryshme të cilët bëjnë thirrje në kauzën e tyre, që padyshim është nxitja, thirrja apo përdorimi i dhunës.⁶⁹ Grupacionet ekstremiste afirmimin e tyre në media dhe dëshirën për të informuar opinion e gjërë lidhur me veprimtarin e tyre tentojn ta arrijnë edhe nëpërmjet marrjes përsipër të sulmeve të ndryshme që ndodhin në vende të ndryshme të botës. Pasi ndodh një ngjarje që tangon opinionin në përgjithësi automatikisht shfaqet dëshira për ta njohur kryersin e saj dhe jo rastësisht shumë sulme që kanë ndodhur në Turqi, Gjermani, Belgjikë, Francë dhe vende të tjera kryesisht janë marrë përsipër nga ISIS dhe në këtë mënyrë ato kanë afirmuar veprimtarin e tyre të dhunshme në opinion duke shfytëzuar edhe mundësin e prekjes së ndjenjave të atyre individëve apo grupacioneve të cilët përfaqësojnë ndajnë të njëjtat mendime sikur ta, me qëllim të rekrutimit të tyre apo radikalizmit të tyre nëpër vendet e tyre ku jetojnë. Pra, duke shfaqur në media të ndryshme veprime të dhunshme mund të ndikohet te ajo kategori njerëzish të cilët kanë në mendje veprime të tilla dhe ato informacione mund ti shërbejnë si shembull për të realizur ndonjë veprim të tillë të dhunshëm, andaj jo të ralla janë rastet kur dikush dëshiron të emitoj veprimtarin e dikujt tjetër, e njëjta gjë pak a shumë sikurse dikush që dëshiron të emitoj ndonjë artist të ndonjë filmi të caktuar.⁷⁰

Me qëllim të ruajtjes së interesave të përgjithshme dhe mbrojtjes së shoqërisë nga dukuritë negative, mediat duhet gjithnjë të pasqyrojnë realitetin, kjo në fakt aq sa është në dobi të shoqërisë aq është edhe në dobi të tyre pasi që në këtë mënyrë ato fitojnë besueshmëri më të madhe në opinionin e gjërë. Kjo për fat të keq në realitet nuk ndodhe dhe në këtë mënyrë shumë media për interesa të ngushta materiale shpërndajn informacione propaganduese me lloj-lloj përmbajtjesh në to, në dëm të përgjithshëm apo të njëjtat bien nën ndikim të qarqeve apo pushteteve të ndryshme, proklamues të dhunës dhe si rezultat i gjithë këtyre ngjarjeve për pasojë kemi: rekrutim online, përsosje kriminale, zhvillim të aktiviteteve të ndryshme të kundërligjshme apo një sërë ngjarjesh kriminale të dhunshme që shkojnë në dëm të shoqërisë në përgjithësi. Media transparente dhe të lira nga çdo ndikim bazë e shëndosh për evitim të dukurive negative në shoqëri.

⁶⁹ Shih në, https://www.youtube.com/watch?v=m4yd1k_mIYA, publikuar më, 7.nëntor.2013, i qasshëm më 4.prill.2017, <https://www.youtube.com/watch?v=9aWssDYSP8>, publikuar më 29.prill.2014, i qasshëm më 4.prill.2017, <https://www.youtube.com/watch?v=fjpnmGumVe4>, publikuar më 7.qershor.2015, i qasshëm më 4.prill.2017

⁷⁰ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.262-269, shih në <http://www.newsday.com/opinion/isis-attacks-in-belgium-and-turkey-have-one-thing-in-common-failed-anti-terrorism-policy-1.11990948>, publikuar më, 30.qershor.2016, i qasshëm më 4.prill.2017, <http://www.evropaelire.org/a/28207939.html>, publikuar më 1.janar.2017, i qasshëm më 4.prill.2017

3.6. Shkalla e edukimit dhe arsimimit në raport me ekstremizmin e dhunshëm

Njeriu në një rreth të caktuar ose në një shoqëri konkrete mund të dallojë për disa karakteristika nga njerëzit e tjerë apo çdo njeri ka karakteristika të veta të cilat specifikojnë karakterin e tij konkret dhe mund të thuhet se ndër to bëjnë pjesë edhe edukata dhe arsimimi. Pa të dyja këto elemente njeriu është i humbur, sidomos pa edukatën pasi që dihet se arsimim arrihet në mënyrë vullnetare dhe sipas mundësive materiale. Shumë njerëz mund të arrijnë shkallë të lartë të arsimimit megjithatë nëse kanë mungesë të edukatës, e tërë ajo dije mund të orinetohet në veprime që shpijnë në dukuri negative. Edukata fitohet që në fillimet e para të çdo njeriu respektivisht prej momentit kur njeriu fillon të vërej gjërat, në këtë drejtim fillimisht si model ka prindërit dhe më pas mësuesin në hapat e para shkollorë, apo si burime të edukatës së një individi konkret janë fillimisht familja e më pas edhe institucioni arsimor në nivel të caktuar që ka për obligim krahas ofrimit të njohurive edhe ofrimin e edukatës (shkolla fillore dhe e mesme). Sjellja në shoqëri, në rrethana të ndryshme, në vende publike apo në mjedise të tjera, e një individi pasqyron edukatën e tij, fillimisht familjare dhe më pas edhe atë të fituar.

Shkalla e arsimimit paraqet komponent shumë të rëndësishëm në formësimin intelektual të individit, poashtu edhe për realizmin e qëllimeve të ndryshme në shoqëri, e njëjta varet prej çdo individi konkret se në cilën shkallë të arsimimit do të arrijë dhe kështu kemi një klasifikim të njerëzve në bazë të shkallës së arsimimit edhe atë në: filloristë, ato të cilët kanë mbaruar vetëm arsimin fillor, të mesëm respektivisht ato njerëz të cilët kanë të mbaruar arsimin e mesëm dhe superior, apo ato me arsim të lartë dhe më pas arrijnë e specializimeve ose titujve shkencorë të ndryshme në fusha, lëmi të ndryshme shkencore. Është e njohur se personat me edukatë të lartë dhe me arsimim të lartë në të shumtën e rasteve më drejtë i vlersojnë ndryshimet që ndodhin në shoqëri edhe pse mund të ketë përjashtime, megjithatë në krahasim me ato të cilët kanë mungesë edukate dhe arsimimi dallimi është shumë i madh. Mungesa e edukatës mund të shpijë me ose pa vetëdije në një sjellje e cila në realitet është e keqe e të duket si e mirë, ndërsa mungesa e arsimimit mund të shpijë në mosnjohjen e dukurive të caktuara negative në mënyrë të duhur, siç është rasti edhe me ekstremizmin e dhunshëm. Shumë njerëz si rezultat i mosnjohjes së vërtet të sjelljes së personave të ekstremizuar, llogarisin veprimet e tyre si të dhura dhe si pasojë përfundojnë në veprime të njëjta ekstreme.

Bazuar në të dhëna statistikore sa i përket ekstremizmit të dhunshëm fetar shumica e të rekrutuarve vijnë nga familje me mungesë edukate dhe me shkallë arsimimi të ulët, pa përjashtuar edhe një përqindje të vogël e cila ka shkallë arsimimi të lartë.⁷¹ Kjo dallon në llojet e tjera të ekstremizmit si ai politik, etnik, nacional apo racorë, ku si persona të ekstremizuar krahas shtresës së sipërpërmendur paraqiten në përqindje më të madhe edhe personat të cilët njihen me edukatë dhe arsimim të lartë shkencorë në opinion apo në shoqëri. Në aspekt kriminologjik të trajtimit të kësaj dukurie, personat me shkallë të ulët të edukimit dhe arsimimit kryesisht kryejn

⁷¹ Shih në, <https://en.zamanalwsl.net/news/15089.html>, publikuar më, 4.korrik.2017. i qasshëm më 11.maj.2017

krime të imëta, pa përjashtuar mundësin e kryerjeve edhe të krimeve të rënda, megjithatë kjo kategori më së shumti është e orientuar në ato të parët përshkak të rezultatit të mosnjohjes së ngjarjeve dhe mundësisë së akceptimit të tyre në mënyrë të duhur, ndërsa personat e edukuar dhe arsimuar fillimisht llogariten si të papranueshëm për të kryer ndonjë krim apo për tu kyçur në ndonjë dukuri ekstreme, mirëpo kjo është apsolutisht e pa vërtet pasi që sot krimet më të rënda kryhen pikërisht nga njerëz të edukuar dhe shkolluar mirë, si lloji i krimeve të jakës së bardhë apo krimet e kryera nga pushtetarët, krime ekonomike, kibernetike, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, korupsioni, bashkëpunimi apo bashkëveprimi me organizata kriminale dhe ekstreme dhe shumë krime të tjera. Thënia e Viktor Hygos „Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu” vlen për ato të shkolluar të cilët dëshirojnë evitimin e dukurive negative në shoqëri, por jo edhe për ato të veshurit nën „petkun” e arsimimit-dijes të cilët po burgosin shoqërinë edhe pse në liri.⁷²

Arsimimi gjithsesi se arrihet përmes leximit të literaturës së caktuar dhe e njëjta ka rëndësi shumë të madhe, pasi që nga doktrina e cila marrim varet edhe veprimtaria e mëvonshme, andaj shtrohet çështja se „nuk ka rëndësi se çka lexojmë, por nga cili autor e lexojmë”, sepse dihet leximi është ushqim i trurit, ndërsa autorë të librave të ndryshëm mund të bëhen „shpërlarës së trurit” dhe në këtë mënyrë formacione të ndryshme duke i ofruar masës literaturë kontraverze dëshirojnë që të ndikojnë ose të indoktrinojnë tek ato që në mënyrë të gabuar ti perceptojnë gjërat dhe të bijen preh e qëllimeve të tyre të këqija. Përmes literaturës së gabuar bëhet shpërlarje truri dhe arsimimi i fituar orientohet në drejtim të gabuar. Në një konferencë ndërkombëtare në lidhje me çështjen e ekstremizmit të dhunshëm është konstatuar se “është e nevojshme që të bëhet një hulumtim në mes mardhënieve të arsimimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë atë se si arsimimi mund të ndikojë potencialisht në nxitjen dhe tërheqjen e faktorëve që lidhen me radikalizimin dhe rekrutimin në ekstremizmin e dhunshëm dhe se e njëjta do të na ofrojë të dhëna si sasiore ashtu edhe cilësore, se si qasja në arsim mund të rrisë ose të zvoglojë radikalizimin dhe rekrutimin në formacione të ndryshme ekstreme, poashtu të bëhet identifikimi i llojit të korikulës e cila ka ndikim më të madh në radikalizimin dhe rekrutimin në ekstremizmin e dhunshëm, si dhe hulumtim i metodave që përdorin profesorët e të cilat kanë ndikim në radikalizim dhe rekrutim në ekstremizmin e dhunshëm. Duke bërë hulumtime, analiza dhe krahasime të këtylla, të ndikohet në përmisimin e mangësive që vijnë nga sfera e arsimit dhe në këtë mënyrë të vijë edhe të parandalimi i dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm, që si burim ka literaturën e gabuar apo keq arsimimin”⁷³

⁷² R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.260-262

⁷³ S,Zeiger, CVE research brief 2, Education and counterin violent extremism, December, 2014, poashtu shih në <http://www.hedayahcenter.org/search/sara%20zeiger%20education%20and%20countering%20violent%20extremism/1>, dhe <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-228201585054.pdf>, publikuar më dhjetor 2014, i qasshëm më 10.qershor.2017

3.7. Familja dhe rrethi shoqëror në raport me ekstremizmin e dhunshëm

Bërthama e një shoqërie të shëndosh është familja. Në çfarëdo forme në qoftë se arrihet që të rruhet ky institucion që ka emrin familje, padyshim se do të kemi një shoqëri të shëndoshë në të gjitha drejtimet shoqërore. Çdo individ rrjedh apo ka prejardhjen prej një familje të caktuar dhe në këtë mënyrë fillon ajo lidhja zinxhirore, individ-familje-rreth shoqëror, përkatësisht individ-familje-lagje, fshat, qytet, shtet dhe kështu që familja e shëndosh na sjell në vete vyrtime të dobishme shoqërore dhe na largon nga dukuritë apo veset negative. Shumicën e gjërave ne si individ i mësojmë fillimisht nga familja e më pas edhe nga ndikimi i rrethit shoqëror dhe kështu krijojmë disa karakteristika me të cilët veçohemi nga njerëz të tjerë dhe në një formë paraqitemi si përfaqësues të familjes së caktuar apo rrethit të caktuar shoqëror. Familjes i takon roli pazëvendësueshëm në formësimin e personalitetit të njeriut, e më pas të gjithë faktorëve të tjerë si ambienti fqinjësor, rrethi shoqëror, arsimimi, etj.

Duke u bazuar në rëndësinë që ka institucioni familje, e njëjta është e rregulluar edhe me dispozita pozitive të pothuajse të gjitha shteteve poashtu edhe me norma morale fetare, në këtë drejtim në R.M.së, ligjvënësi ka paraparë ligjin mbi familjen, ndërsa në aspekt fetar kjo çështje është e rregulluar me ajete Kur'an-ore, dispozita shariatike edhe me Hadithe të pejgamberit Muhammedit a.s. i cili na ka urdhëruar që fillimisht të martohemi, e më pas të kujdesemi për familjen ashtu siç kujdesemi për sytë e ballit, poashtu kjo çështje është e rregulluar edhe në bazë të mësim besimeve të tjera.⁷⁴ Çdo njeri normal padyshim dëshiron që të jetoj në një familje të shëndosh dhe një rreth shoqëror të shëndosh, ku mbisundojn gjërat pozitive harmonia dhe vlerat, pasi të dy këto komponenta familja dhe rrethi shoqëror paraqesin bazë themelore për përparim të përgjithshëm në të gjitha sferat shoqërore, ato përcaktojnë orientimet e para, japin udhëzime mbi sjelljet e lejuara dhe të palejuara, mbi normat morale dhe ndalesat e ndryshme, gjithashtu paraqesin urë lidhëse të individit me botën e jashtme dhe në këtë formë kontribuojn në krijimin e një shoqërie stabile dhe përplot vyrtime e në të cilat veset negative nuk kanë vend. Mirëpo për fat të keq, jo të gjitha familjet janë në nivel të detyrës së tyre, jo të gjitha i përmbushin obligimet e tyre, jo të gjitha janë të kompletuara dhe si rrjedhim kemi edhe familje problematike, të shkatruara, të degraduara, të mangëta, etj, të cilat njëherit paraqiten edhe si burim i sjelljeve kriminale dhe negative në shoqëri përfshirë ekstremizmat e ndryshëm, por jo domosdoshmërisht si të tilla.⁷⁵

Kur kemi të bëjmë me familje të kompletuar e të shëndoshë, mund të thuhet se gjithçka është në rregull dhe se mundësia e kyqjes së anëtarëve të një familje të tillë në veprime kriminale, ekstreme apo veprime të tjera të ngjajshme negative është pothuajse e pamundur edhe pse përjashtimet janë prezente në çdo rast, mirëpo bazuar në themelin e fortë që ka një familje e

⁷⁴ Shih në, http://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osemjestvo_osnoven.pdf, i qasshëm më 30.maj.2017, dhe në përmbledhjen e Haditheve, Sahih el Buhari.

⁷⁵ R.Halili, Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në Kosovë, Prishtinë,1987, fq.17-20

tillë ku mbisundon rregulla, harmonia, mirëqenia, sjellejt e ndaluara janë të papranueshme. Problemet në literaturë dhe në bazë të të dhënave të ndryshme statistikore paraqitet tek familjet e emërtuara si të degraduara, problematike, të rëna, të shkatëruara, shumë anëtarëshe, etj. Te këto familje zakonisht jetohet në disharmoni, në konflikte të ndryshme ndërmjet anëtarëve dhe të gjitha këto rrethana nxisin pakënaqësi të cilat përfundojnë në forma të ndryshme duke filluar prej shthurjes së bashkësisë familjare respektivisht ndarjes së bashkëshortëve, braktisja dhe lënia e familjes nga të dy prindërit apo nga njëri prind, ikja e fëmijëve nga familja, mosrespektimi i prindërve nga ana e fëmijëve, e gjithë kjo e shëndëruar në një atmosferë të padurueshme, e që në një formë ndikon që anëtarë të familjeve të këtilla të jepen pas disa veprimeve dhe sjelljeve negative, antiligjore dhe të dënushme, poashtu e gjithë kjo situatë ndikon që ato të bijen më lehtë preh e grupeve të ndryshme kriminale, përfshirë organizatat kriminale, organizatat ekstreme, të cilat kanë për qëllim dhe synim të rekrutojnë sa më shumë njerëz në mesin e tyre, për të lehtësuar veprimtarinë e tyre negative.⁷⁶

Familja e cila nuk është e aftë që anëtarëve të vet t’iu ofroj edukim dhe formësim të drejtë, me ose pa të drejtë në literaturë konsiderohen se familjet e tilla shndërohen në vatra dhe burime të sjelljeve kriminale, e gjithë kjo në bazë të të dhënave nga praktika gjyqësore që vërteton se sjelljet kriminale në numër të madh rrjedhin nga delikuent që janë pjesë e familjeve të çrregulluara, ku ka konflikte në mes të prindërve dhe probleme të ndryshme familjare. Zakonisht, familjet e degraduara, çrregulluara apo të rrëna për shkak të mënyrës së të jetuarit, humbin autoritetin në rrethin familjar të tyre dhe atë shoqëror. Te këto familje është e pranishme konsumimi i alkoolit, drogës, luhet bixhoz apo është i pranishëm edhe prostitucion ose ndryshe thënë të gjitha sjelljet amorale dhe të ndaluara, dhe kështu ato izoloohen, braktisen nga familja më e afërt dhe rrethi i caktuar shoqëror. Për dallim nga këto familje, te familjet deficiente apo të mangëta dhe te familjet shumë antarëshe paraqiten probleme të tjera. Për shkak të strukturës jo të plotë të familjes, si rezultat i mungesës së ndonjërit prej prindërve ose të dy prindërve, apo mungesa e ndonjë anëtari tjetër të familjes dhe bazuar në arsyen e mungesës së tillë paraqiten probleme të ndryshme që shumë herë përfundojnë me sjellje devijante, kriminale. Mungesa e ndonjë anëtari të familjes, shkakton dhimbje të mëdha, çrregullime dhe trauma të ndryshme përfshi ato psikike te pjesa tjetër e familjes dhe në këtë formë për shkak të kësaj gjendje të krijuar ekspozohen më lehtë ndaj ndikimeve të jashtme. Familjet shumë anëtarëshe kryesisht ballafaqohen me probleme të karakterit social, përkatësisht atë të sigurimit të kushteve normale të jetesës për të gjithë anëtarët e familjes. Për shkak të numrit të madh të anëtarëve, nevojat dhe kërkesat e tyre janë të shumëfishta edhe pse mund të jenë reale dhe te nevojshme, megjithatë krizat e ndryshme, papunësia, varfëria pamundësojnë realizimin e kërkesave dhe në këtë drejtim në familje të tillë paraqiten konflikte të ndryshme dhe anëtarët e familjes së tillë fillojnë që shumë herët të marrin fatin në duart e tyre, por jo gjithëherë në mënyrë ligjore dhe të lejuar. Mungesa e edukimit, arsimimit dhe harmonisë ose ndjesisë së familjes së lumtur, shpeshherë i shpie në sjellje ekstreme dhe kriminale, gjithashtu u mundëson organizatave të ndryshme

⁷⁶ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.278

ekstreme që më lehtë të fusin në gjirin e tyre individ apo grupe njerëzish nga këto familje, poashtu i mundëson edhe literaturës që ti llogaris në mesin e familjeve problematike, edhe pse ka raste ku mund të ndodh e kundërta që numri i madh i anëtarëve mos të paraqes aspak problem dhe asnjë anëtar mos të jetë i inkriminuar në sjellje devijante apo të kundërligjshme, nga ku mund të kuptojmë se jo çdoherë ka rëndësi struktura e familjes respektivisht numri, por krahas kësaj rol shumë të rëndësishëm luajn edhe faktorë të tjerë sidomos ai financiar.⁷⁷ Të gjitha këto familje me probleme të theksuara në mënyrë indirekte ndikojnë në paraqitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe formave të tjera të sjelljeve devijante dhe kriminale, poashtu paraqiten si faktorë kyç në veprimtarin e ndonjë anëtari të familjes, ndërsa pasojat i vuan e tërë shoqëria. Familja e shëndoshë bazë ose burim për një shoqëri të shëndosh dhe të lumtur.

Krahas familjes edhe rrethi i caktuar shoqëror, qoftë ai i ngushtë apo më i gjerë ndikon në ndërtimin e personalitetit të individit, së këndejmi edhe në veprimtarinë e tij. Ky konstatim vjen duke u bazuar në atë se një periudhë të kohës respektivisht të ditës e kalojmë nën shoqërimin e një rrethi të caktuar shoqëror jashta shtëpisë dhe rrethit familjar. Pra, një periudhë kohore brenda ditës e kalojmë në lagje, në rrugë, shkollë, punë, fshat apo qytet. Ndeja më njerëz të moralshëm, të dijes dhe me plotë vrytite të tjera pozitive padyshim që ka ndikim pozitiv dhe të dobishëm si për ne ashtu edhe mbarë shoqërinë dhe anasjelltas ndeja me njerëz problematik, të pamoralshëm, të pajisur me plotë vese negative padyshim se na shpie në një humnerë të sigurtë dhe pasojat e tilla i vuan e tërë shoqëria. Kalimi i kohës së caktuar në një rreth të caktuar mundëson mëshirimin tonë në atë ambient dhe në situata të caktuara mund të ndërmarim veprime ndonëse edhe jo mirë të menduara apo paramendura, por duke ju nënshtruar veprimeve të rrethit të caktuar ose me fjalë të tjera ndikimit të tyre indirekt, edhe pse veprimet e tilla mundë të jenë ekstreme, të dhunshme apo veprime kriminale dhe jo rallëherë si rezultat i këtij ndikimi individ apo grupe njerëzish kanë përfunduar në organizata ekstreme, kriminale. Duke u shoqëruar me njerëz të cilët kanë lidhje me organizata ekstreme qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, ndikimi i tyre është pothuajse i pashmangshëm bazuar në strategjinë, teknikat dhe taktitat të cilat përdorin organizatat e tilla dhe në këtë mënyrë përfundimi i shoqërimit me njerëz të atillë mund të jetë pjesëmarrja aktive në ekstremizimin e dhunshëm. Andaj, fakti se familja dhe rrethi shoqëror kanë rol të pazëvendësueshëm në formësimin e personalitetit, ndikimi i tyre indirekt është prezent në çdo drejtim apo vendimarrje të individit edhe pse jo përfundimtar ose vendosës, në kuptimin e asaj se çdo individ ka aftësinë e kontrollit të veprimeve të veta.⁷⁸

⁷⁷ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 279-281

⁷⁸ E. Sahiti, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë, fq. 75-76

IV. Viktimat e ekstremizmit të dhunshëm

4.1. Viktimizimi nga ekstremizmi i dhunshëm, në përgjithësi

Sa herë që përdoret termi viktimë, pothujase të gjithë e kanë të qartë se dikush ka pësuar ndonjë dëm ose i ka ndodhur diçka që është në kundërshtim me interesat e tij. Fjala viktimë rrjedh nga fjala latine „victim” dhe folja vincere, vaincere dhe ka kuptimin e flijimit, pësimit, dëmtimit, sakrifikimit, viktimizimit, shkatërimit të pasurisë, ndërsa shkenca e cila merret me studimin e saj quhet viktimologji. Fjala viktimë në esencë nënkupton personin ose grupin e caktuar që ka pësuar, që është dëmtuar si rezultat i veprimeve të ndryshme qofshin ato të shkaktuara nga njeriu, kafshët, fatkeqësti natyrore etj. Në përgjithësi flitet për viktimë humane, shtazore dhe bimore, kurse me një shprehje karakterizohet i tërë procesi i pësimit të njeriut që quhet „viktimizim” e që nënkupton një numër të pacaktuar veprimesh keqbërëse që rrezikojnë, asgjësojnë, dëmtojnë dhe kërcënojnë të mirat dhe vlerat elementare të njeriut. Në fakt kur përdoret termi viktimizim mendohet për mënyrat, rrugët, trajtat e dëmtimit, shkallën dhe intensitetin e saj. Në viktimologji poashtu përdoret edhe një nocion tjetër i rëndësishëm që nënkupton tërësin e rasteve viktimizuese, që kanë ndodhur në një vend brenda një periudhe të caktuar kohore, që emërtohet si viktimitet.⁷⁹

Lidhur me kuptimin e fjalës viktimë ekzistojnë shumë përkufizime megjithatë si më i pranueshëm llogaritet përkufizimi në bazë të dispozitave të Deklaratës mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit, dhe në bazë të kësaj deklarate „si viktimë konsiderohen personat të cilët në mënyrë individuale dhe kolektive kanë pësuar dëm, përfshirë aty edhe lëndime fizike ose mendore, pësime emocionale, humbje ekonomike apo humbje substanciale të të drejtave të tyre, si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve, të cilat shkelin ligjin penal në fuqi në shtetet anëtare, përfshirë edhe ato ligje, të cilat ndalojnë keqpërdorimin e pushtetit”.⁸⁰ Poashtu, është shumë e rëndësishme të theksohet se në bazë të kësaj deklarate si viktimë llogariten të gjithë ato të cilët kanë pësuar dëme të ndryshme pa marrë parasysh besimin, racën, gjininë, moshën, përkatësinë etnike, mendimin politik ose ndonjë dallim tjetër. Mjafton të kenë pësuar dëm për tu llogaritur si viktimë. Ekzistojnë edhe shumë përkufizime të tjera, megjithatë patjetër duhet theksuar edhe atë të cilën lidhet me viktimat e ekstremizmit të dhunshëm dhe akteve terroriste. Sipas rekomandimit të komitetit të ministrave të këshillit të Evropës, nr.8/2006, mbi mbrojtjen e viktimave të krimit dhe viktimave të akteve terroriste, si viktimë konsiderohen: personat natyral(civil), të cilët kanë pësuar dëmtime, duke përfshirë lëndime fizike dhe mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike nga veprimet ose mosveprimet, që paraqesin shkelje të ligjit penal të shtetit anëtar. Termi viktimë gjithashtu përfshin, në raste të caktuara edhe anëtarin e familjes ose personat e tjerë të cilët në mënyrë të

⁷⁹ R.Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2011, fq. 7-15

⁸⁰ Po aty, fq.47

drejtëpërdrejtë janë të varur nga viktimat.⁸¹ Krahas shumë problemeve dhe dukurive negative të paraqitura në shoqëri terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm gjithnjë e më shumë po shkaktojnë pasiguri dhe viktima në vende të ndryshme të botës dhe me ç'rast edhe numri i tyre është gjithnjë në rritje, qofshin ato të cilët pësojnë në mënyrë direkte me humbjen e jetës apo ato të cilët pësojnë vuajtje psikike, emocionale apo dëme materiale.

Si viktima të terrorizmit konsiderohen ato të cilët janë vrarë apo lënduar nga një sulm terrorist përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes së atyre të cilët janë vrarë apo lënduar nga i njëjti sulm, ndërsa si viktima të ekstremizmit të dhunshëm konsiderohet çdokush që në një formë kycet në ndonjë formacion ekstrem apo pëson nga i njëjti, me qëllim të arritjes së ndryshimit politik, ideologjik apo religjioz. Kyçja në formacione ekstreme konsiderohet viktimizim në vete, pasi që çdo individ ose grupacion ekstrem më së shumti fillimisht i bën dëm vetes dhe të afërmive të tyre dhe më pas të tjerëve. Shënjestër e sulmeve terroriste dhe ekstremizmit të dhunshëm nuk janë viktimat personalisht, por sulmet janë të orientuara kryesisht kundër politikës ose menaxhimit të shtetit respektivisht kundër ideologjisë, religjionit apo politikës së vendit në të cilën ndodh një sulm i tillë dhe në këtë mënyrë viktimat janë të ndryshëm nga sulmet kriminale apo të ndonjë forme tjetër të kundërligjshme të atakimit të tyre dhe si të tillë duhet të njihen nga shteti dhe shoqëria.⁸² Me qëllim të mbrojtjes së viktimave, ato duhet të mobilizohen. Në bazë të të dhënave nga viktimat të cilat kanë pësuar paraprakisht, shteti, shoqëria civile poashtu edhe institucionet kompetente fetare duhet të përgadisnin një strategji qoftë në mënyrë individuale secila prej tyre apo bashkërisht dhe në këtë mënyrë të bëhet preventimi dhe mobilizimi i viktimave të mundshme. Para se viktimat të jenë të gatshëm dhe të aftë për tu mbrojtur nga ekstremizmi i dhunshëm ato kanë nevojë:“ të njihen nga shteti, mos të ndihen të vetëm; të mbrohen dhe të sigurohen nga sistemi ligjor ose komuniteti; të bëhet menaxhimi praktik i pasojave të sulmit: fizik, emocional, mendor, ekonomik apo social; të mos ndiejnë faj apo turp në familje dhe në shoqëri; të kuptojnë traumën e tyre, përfshirë edhe sëmundjen psikomatike e që për gjithë këto duhet një kohë e konsiderueshme që mund të zgjasë me muaj ose me vite”.⁸³

Çdo individ që ka pësuar nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë shumë i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e tij. Ndiham të cilën viktimat mund ti ofrojnë shoqërisë në gjetjen e zgjidhjes kundër këtij fenomeni është shumë e madhe, sepse më mirë se viktima askush nuk ka njohuri për tërë atë proces. Në këtë drejtim, disa lloje të ndihmave të cilat viktimat mund t'ia ofrojnë shoqërisë konsistojnë në: Përmes dëshmimeve personale të rrëfejnë për atë se çka ka pësuar, duke zhvilluar biseda në tubime publike të rrëfejnë për atë se kush ka ndikim që një person të bije në kthetrat e qarqeve ekstreme, cilat programe arsimimi, kulture ose edukimi mund të kenë një ndikim të tillë, të paraqesin në media ngjarjen të cilën e kanë përjetuar, të solidarizohen me viktimat e tjera duke i dhënë mbështetje njëri-tjetrit, të mbrojnë

⁸¹ R.Halili, Viktimologjia, Prishtinë, fq.49

⁸² Shih në, <http://www.hedayahcenter.org/activities/80/activities/307/2013/313/victims-as-a-face-of-countering-violent-extremism-roundtable> & <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-34201675519.pdf>, pg. 1-2 publikuar më 2-3 shtator.2013, i qasshëm më 15.qershor.2017

⁸³ <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-34201675519.pdf>, pg.3

veten dhe viktimat e tjera nga viktimizimi sekondar, të mobilizojnë shoqërinë kundër joshjeve të ndryshme të cilat kanë përfundim të errët, të ndihmojnë politikat strategjike të shtetit kundër fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, shoqërinë civile dhe organet kompetente religjioze, të ofrojnë zgjidhje dhe informacione në lidhje me procesin e deradikalizimit dhe në këtë mënyrë ti ndihmojnë shoqërisë duke promovuar veten si ambasador kundër ekstremizmit të dhunshëm.

4.2. Klasifikimi i viktimave të ekstremizmit të dhunshëm

Për të ekzistuar një ngjarje, krim apo dukuri negative, duhet së paku të ketë dy protagonistë ku njëri shfaqet në rolin e kryerësit ndërsa tjetri në rolin e viktimës, e njehta ndodh edhe tek ekstremizmi i dhunshëm. Nga ky relacion në mes kryerësit dhe viktimës dhe varësisht edhe prej kontributit të tyre në ngjarje, në literaturën viktimologjike hasim klasifikimin e viktimave të krimeve apo dukrive tjera të rrezikshme si terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në vijim do të paraqesim disa klasifikime të viktimave të bëra nga profesor eminent të sferës së viktimologjisë.

Sipas profesorit kroat të viktimologjisë Dr. Z. Shepareviq ekzistojnë disa tipe të viktimave, varësisht nga kontributi, vetitë dhe cilësit fizike, sociale apo relacioni i tyre me kryerësin e rastit viktimizues, sipas tij dallojmë këto lloje të viktimave: Viktima vullnetare, viktima të panjohura, viktimë e pavëmendshme, viktima simuluese dhe viktima të mbetur në tentativë.⁸⁴ Sipas Hans Hentingut dallojmë viktima të cilët pësojnë për shkak të ndikimeve të faktorëve psiko-biologjik dhe viktima të cilat pësojnë për shkak të ndikimeve të faktorëve të natyrës sociologjike dhe një klasifikim tjetër bazuar në kontributin e viktimës në procesin e viktimizimit i ndanë ato në viktima të krimit dhe viktima potenciale.⁸⁵ Sipas Benjamin Mendelsohn viktimat ndahen në: viktima të krimit dhe në viktima që bëhen si të tilla për shkak të vetekspozimit. Ndërsa viktimat e krimit i klasifikon në : viktima tërësisht të pafajshme, viktima më pak të fajshme, viktima fajtoare sa edhe vetë viktimizuesi, viktima provokuese dhe viktima e vetme fajtoare.⁸⁶ Sipas Ezat Fattah viktimat në bazë të kontributit i klasifikon në: Viktima që nuk merr pjesë gjatë viktimizimit, viktima abstrakte, pa emër dhe jospecifike, viktima sprovuese, viktima që e lutë kryerësin ta viktimizoj si dhe viktima provokuese.⁸⁷ Sipas gjermanit Schwind viktimat klasifikohen në: viktima të situatës, viktima në raportet familjare, viktima për shkak të profesionit apo mjeshtërisë, viktima për shkak të lakmisë dhe përfitimit material, viktima për shkak të sjelljeve vetjake, viktima për shkak të përkatësis sociale, viktima për shkak të gjendjes së veçantë biofizike dhe biopsikike dhe viktima të rastit.⁸⁸ Përkundër këtyrë klasifikimeve lidhur

⁸⁴ R.Halili,Viktimologjia,Prishtinë,2011,fq.54-55

⁸⁵ Po aty, fq.56

⁸⁶ Po aty,fq.57

⁸⁷ Po aty fq.58

⁸⁸ R.Halili,Viktimologjia,Prishtinë,2011,fq.58-59

me viktimat e krimit në përgjithësi, viktimat e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit si lloje të tmershme të krimeve dallojnë dhe kanë karakteristikat e tyre të veçanta apo specifike nga viktimat e krimeve të tjera. Ndër karakteristika për të cilat dallojnë nga viktimat e krimeve të tjera janë: në të shumtën e rasteve viktimat që pësojnë nga sulmet terroriste apo ekstremiste nuk janë të njohur për viktimizuesin (kryerësin), numri i viktimave prej sulmeve të tilla është shumë i madh, duke dëshiruar në mënyrë të dhunshme të sulmohet apo të ndryshohet ndonjë ideologji, religjion apo qëndrime politike në mënyrë indirekte automatikisht si viktimat të sulmit të tillë llogariten edhe të gjithë ato individë apo grupime që i përkasin një ideologjie, religjioni apo qëndrimi politik të tillë i cili atakohet, individ apo grupe njerëzish pësojnë nga sulmet e tilla vetëm pse janë në një moment të caktuar në një vend të caktuar ku ndodh sulmi pasi që si caqe ekstremistët dhe terroristët kanë vendet publike dhe të frekuentuara nga sa më shumë njerëz, poashtu në qoftë se krimet e thjeshta më pak mendohen apo paramendohen, te këto lloje të krimeve hartohet një strategji paraprake dhe e detajuar me qëllim që dëmi të jetë sa më i madh në viktima, vlen të theksohet poashtu se për dallim nga krimet e tjera ku viktimizuesit dëshirojnë të fshihen, kryerësit e sulmeve terroriste apo ekstremistët e dhunshëm nuk fshihen dhe nuk hezitojnë të marrin përsipër sulmin e kryer dhe pasojat e shkaktuara.

Klasifikimi që mund t'iu bëhet viktimave të ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë i ndryshëm, shumë klasifikime nga autorët e sipër përmendur lidhur me viktimat e krimeve në përgjithësi vlejné edhe për viktimat e ekstremizmit të dhunshëm në veçanti. Do të përmendim dy klasifikime me të cilat identifikohet çdo viktima e ekstremizmit të dhunshëm apo edhe e terrorizmit (edhe terrorizmit pasi që veprimet e të dy-jave këtyre dukurive përkojnë në të njëjtin qëllim-dhunën) edhe atë dallojmë viktimat direkte të ekstremizmit të dhunshëm dhe viktimat indirekte të ekstremizmit të dhunshëm, poashtu klasifikim tjetër në viktimat të atëqashtme dhe viktimat të mëvonshme, mund të bëhen edhe klasifikime në bazë të asaj se varësisht për cilën lloj të ekstremizmit bëhet fjalë, atë politik, religjioz, etnik, nacional apo racorë, megjithatë me klasifikimet e përmendura në fillim identifikohet çdo viktima e ekstremizmit të dhunshëm apo terrorizmit. Me viktimat direkte të ekstremizmit të dhunshëm kuptojmë të gjithë ato individë, grupe njerëzish, apo e tërë popullsia e një vendi apo shteti që ka pësuar dëm qoftë ai lidhur me integritetin trupor, jetën, pronën apo dëme të tjera emocionale apo materiale si pasojë e dhunës së shkaktuar me qëllim të ndryshimit të dhunshëm të ideologjisë, religjionit apo politikës së caktuar në territorin në të cilën ushtrohet dhuna, ndërsa viktimat indirekte konsiderohen të gjithë atë njerëz të cilët pësojnë në mënyrë të tërthortë apo indirekte si rezultat i dhunës ekstreme të shkaktuar me qëllim të realizimit të interesit të sipërpërmendur. Viktimat të atëqashtme konsiderohen ato të cilët pësojnë në momentin e ushtrimit të dhunës ekstreme, ndërsa si viktimat të mëvonshme konsiderohen të gjithë ato njerëz që pësojnë në çfarëdo forme pas ndryshimit të caktuar ideologjik, religjioz apo politik me anë të dhunës dhe pasojat e ndryshimit të tillë janë të vazhdueshme dhe më afatgjate.

V. Mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm

5.1. Mekanizmat të cilat i ka paraparë Republika e Maqedonisë

Shteti si një organizatë e tipit të veçantë (sui generis), që ka një pushtet sovran që shtrihet dhe ushtrohet në një territor të caktuar në të cilën jeton dhe vepron një popullsi e caktuar e cila sillet në bazë të normave të cilat i përcakton pushteti i atij shteti, është i obliguar që ti mbroj të gjithë ato njerëz nga çdo dukuri negative, përfshirë edhe ekstremizmin e dhunshëm. Meqë me shtetësi nënkputojmë lidhjen juridike në mes të qytetarit/ve me shtetin, atëherë nga ky raport reciprok burojnë një sërë të drejtash dhe detyrimesh në mes këtyre palëve. Qytetarët kanë një sërë obligimesh ndaj shtetit si p.sh. të sillen në bazë të dispozitave pozitive të shtetit konkret, të paguajnë tatim, të mbrojnë interesat e shtetit, etj. Poashtu edhe shteti ka një sërë obligimesh ndaj qytetarëve edhe atë të njohë në mënyrë absolute të gjitha të drejtat civile dhe politike të tyre, të kujdeset dhe të ju ofrojë mirëqenie, të menjanojë problemet infrastrukturore, të garantoj siguri të jetës, pronës dhe shumë obligime të tjera. Obligimet e qytetarëve ndaj shtetit mund të konsiderohen si të drejta të shtetit ndaj tyre dhe anasjelltas obligimet e shtetit ndaj qytetarëve mund të konsiderohen si të drejta të qytetarëve.

Çështja e sigurisë është ndër problemet themelore pothuajse të të gjitha shteteve në botë, andaj në këtë drejtim gjithnjë e më shumë shtohet angazhimi i tyre për të zgjidhur këtë problematik. Siguria e shteteve dhe qytetarëve të saj në të shumtën e rasteve atakohet nga sulmet e ndryshme terroriste, ekstremizmi i dhunshëm, grushtetet, forma këta të dhunshme për të arritur ndryshime kryesisht ideologjike dhe politike dhe për të shkaktuar frikë dhe tmerr në masë. Si çdo shtet ashtu edhe Republika e Maqedonisë ka paraparë masa të ndryshme për të parandaluar dhe luftuar dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit apo edhe formave të tjera të atakimit të shtetit respektivisht interesave shtetërore. Çka ka bërë R.M.-së dhe a ka gjetur zgjidhje adekuate në drejtim të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm është çështje e cila duhet trajtuar dhe analizuar mirë, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga kjo dukuri negative. Aktiviteti i organeve kompetente për ruajtjen e sigurisë së shtetit konsiston në inkriminimin me dispozita pozitive ligjore si vepra penale të gjitha ato veprime që rrezikojnë shtetin dhe qytetarët e tij, poashtu në hartimin e strategjisë adekuate kundër terrorizmit në të cilën përfshihet edhe ekstremizmi i dhunshëm. Që do të thotë se R.M.së, ndonjë strategji konkrete kundër ekstremizmit të dhunshëm nuk ka, por ka strategji kundër terrorizmit në të cilën përfshihen edhe mënyrat për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në Kodin penal të R.M.,së janë bërë disa ndryshime. Në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër shtetit është bërë inkriminimi si vepër penale, i të gjithë atyre veprimeve që në vete përmbajnë ekstremizëm të dhunshëm. Duke e trajtuar problematikën e ekstremizmit të dhunshëm ma shumë si çështje të jashtme nenit 322 të KPM, Shërbim në ushtrinë e armikut i është plotësuar në „322-a” që do të thotë si vepër penale në bazë të nenit 322-a të KPM është paraparë: pjesëmarrja në

formacione të huaja ushtarake, policore, paraushtarake apo parapolicore. Me qëllim të njoftimit të lexuesit se cila është përmbajtja e neneve që kanë të bëjnë me dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm, do të pasqyroj nenet një nga një të cilët kanë të bëjnë me këtë problematik dhe në këtë mënyrë të fitohet dije adekuate dhe e nevojshme për të shmangur dënimin eventual si pasojë e ndeshjes me këto nene.

“Neni 322, Shërbim në ushtrinë armike.”⁸⁹

(1) Qytetari i R.M.,së i cili në kohë lufte apo konflikti të armatosur shërben në ushtri armike apo në formacione të tjera të armatosura armiqësore ose merrë pjesë në luftë apo konflikt të armatosur si ushtar kundër R.M.së, apo aleatëve të saj, do të dënohet me dënim me burgim më së paku tre vjet.

(2) Ai i cili rekruton qytetarë të R.M.,së për të shërbyer në ushtri armike apo në formacione tjera armiqësore ose merrë pjesë aktive në luftë apo konflikt të armatosur kundër R.M.,së apo aleatëve të saj do të dënohet me dënim me burgim më së paku katër vjet.

“Neni 322-a, pjesëmarrja në formacion të huaj ushtarak, policor, paraushtarak apo parapolicor.”⁹⁰

(1) Ai i cili në kundërshtim me ligjin krijon, organizon, rekruton, transporton, organizon transport, aftëson, trajnon ose në ndonjë mënyrë tjetër përgadit individ apo grup për të marrë pjesë në formacion të huaj ushtarak, policor, paraushtarak apo parapolicor, në grup të organizuar apo në mënyrë individuale, jashta territorit të R.M.,së, do të dënohet me dënim me burgim më së paku pesë vjet.

(2) Ai i cili në kundërshtim me ligjin në çfardo forme, direkte apo indirekte, ofron, jep, siguron, kërkon, mbledh ose mbulon mjete financiare, fonde, mjete materiale ose pajisje të cilat në tërësi apo pjesërisht janë të destinuara për kryerjen e veprës penale nga paragrafi (1) i këtij neni, do të dënohet me dënim me burgim prej më së paku pesë vjet.

(3) Qytetari i R.M.,së, i cili në kundërshtim me ligjin do të merrë pjesë ose do të trajnohet në formacion të huaj ushtarak, policor, paraushtarak apo parapolicor, në grup të organizuar apo në mënyrë individuale, jashta territorit të R.M.,së do të dënohet me dënim prej më së paku katër vjet.

(4) Ai i cili në kundërshtim me ligjin në tubim, përmes tekstit të shkruar, me inçizime audio-vizuele, përmes rrjeteve sociale ose në çfarëdo forme tjetër të komunikimit bën thirrje, me

⁸⁹ <http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> i qashëm më 13.tetor.2017, poashtu në: „Службен весник на Република Македонија” број 80/99, број 4/2002 година, број 43/2003, број 19/2004, број 81/2005, број 60/06, број 73/06, број 7/08, број 139/08, број 114/09, број 51/11, број 135/11, 185/11, број 142/12, број 166/12, број 55/13, број 82/13, број 14/14, број 27/14, број 28/14, број 115/14 и број 132/14.

⁹⁰ По ату,

shpërndarjen ose vendosjen në dispozicion të publikut mesazhin për kryerjen e veprave penale nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të këtij neni apo nxit ose shtyn tjetrin në kryerjen e këtyre veprave do të dënohet me dënim prej më së paku katër vite.

(5) Në qoftë se veprat penale të lartëpërmendura do të kryhen ndaj fëmijëve, kryerësi do të dënohet me dënim me burgim prej më së paku pesë vjet.

(6) Ai i cili e fsheh kryerësin e veprës penale nga ky nenë, apo ndihmon në drejtim të pengimit në gjetjen e veprës ose kryerësit të saj duke mshehur mjetet me të cilat është kryer vepra, faktet ose në çfarëdo forme tjetër, do të dënohet me dënim me burgim prej një deri në pesë vjet.

(7) Kryerësi i veprës penale nga ky nenë i cili do ti zbulojë kryerësit nga paragrafet e lartëpërmendura, mund të lirohet nga dënimi.

(8) Për veprën nga paragrafi (3) i këtij neni nuk do të dënohet kryerësi i cili ka shtetësin e shtetit në të cilën në mënyrë të rregullt merrë pjesë apo është anëtar në formacione ushtarake, policore, paraushtarake apo parapolicore, nën kontroll të qeverive të pranuara ndërkombëtarisht ose organizatave ndërkombëtare.

(9) Tentativa është e dënueshme.

(10) Mjetet dhe objektet të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës, konfiskohen.

Ky nenë me këto paragrafe na mundëson të kuptojmë se për çdo veprim që përmban në vete ekstremizëm të dhunshëm, pason sanksion me dënim me burgim, përveç paragrafit (7) të nenit 322-a ku thuheshte se në qoftë se i zbulon kryerësit e tjerë atëher mund të lirohesh nga dënimi. Për ta pasur më të qartë, konkludojmë se si rezultat i mungesës së një plani apo strategjie konkrete në lidhje ekstremizmin e dhunshëm, shteti si të vetmen alterantiv të mbrojtjes së shoqërisë nga kjo dukuri e sheh sanksionimin me ligj të kësaj veprë. Hartimi i një strategjie konkrete për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, fillimisht do tu mundësonte qytetarëve të fitojnë njohuri të domosdoshme për këtë dukuri. Me të do t'iu mundësohej qytetarëve se çfarë në të vërtet do të thotë ekstremizëm i dhunshëm, çfarë kanë për synim këta njerëz, cilët janë metodat apo mënyrat të cilat i përdorin ato për të inkriminuar sa më shumë njerëz, çka e konsiderojn ato dhunën, si mund të parandalohet kjo dukuri, si mund të mbrohet shoqëria nga kjo dukuri dhe krejt në fund se çfarë pëson individi ose grupi në qoftë se kryen një vepër e cila në vete përmban ekstremizëm të dhunshëm. Të gjitha këto informata do të ishin shumë më me interes për shoqërinë, për tu mbrojtur nga kjo dukuri se sa të shkohet direkt në ndëshkim, pasi që duke u bazuar edhe në gjendjen në të cilën ndodhen burgjet në R.M., së burgimi i këtyre personave nuk është zgjidhje adekuate dhe duke u bazuar në atë se personave të dënuar pas kryerjes së dënimit nuk ju ofrohet ndihmë postpenale rreziku mund të jetë edhe më i madh pas daljes së tyre nga burgju. Hartimi i strategjisë konkrete është më se e nevojshme për preventive dhe mbrojtje të shoqërisë. Kjo strategji do të duhej të përmbaj çdo të dhënë në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm, duke filluar nga ato më elementare se çka nënkupton dhe si mund

ta vërejmë e deri në zgjidhjen adekuate dhe efikase të kësaj problematike, gjithnjë në bashkëpunim në mes institucioneve kompetente shtetëror dhe të gjithë faktorëve të tjerë shoqëror. Në vijim do të paraqesim një zgjidhje e cila do të ishte më efikase në krahasim me dënimin me burgim.

Si zgjidhje adekuate e kësaj problematike do të ishte hapja e qendrave speciale për trajnimin dhe trajtimin e personave të ekstremizuar. Institucionet shtetërore kompetente për ofrimin e sigurisë qytetarëve në bashkëpunim me qytetarët e thjeshtë, do të duhej të hartonin një plan, ku do të theksonin se cilët rajone të R.M.,së janë më të rrezikuara nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe në bazë të këtij plani në rajonet konkrete do të duhej të hapen qendra speciale për trajnimin dhe trajtimin e personave të ekstremizuar. Në këto qendra do të punësoheshin ekspert të cilët kanë njohuri të mjaftueshme në këtë fushë, dhe varësisht për cilin lloj të ekstremizmit të dhunshëm do të bëhej fjalë, ashtu edhe do të bëhej edhe klasifikimi nëpër klasa të personave të ekstremizuar apo radikalizuar. Duke u ofruar tretman adekuat, duke u sqaruar atyre se çfarë në të vërtetë do të thotë ekstremizmi i dhunshëm, duke i pajisur ato me dije të nevojshme për ta mbrojtur nga kjo dukuri veten dhe të tjerët, evitimi i veprave të rrezikshme mbrojtja e shoqërisë dhe shtetit do të ishte pothuajse e sigurt.

Duhet theksuar se personat e ekstremizuar në këto qendra nuk do të duhej të rinë të mbyllur në to, por veç një periudhë të caktuar kohore ti ndjekin mësimet e domosdoshme, prezenca e të cilëve do të ishte e patjetërsueshme dhe në rastë mungese të pasonte edhe shoqërimi policor , dhe poashtu të njëjtëve në bazë të identifikimit të shkathtësive dhe aftësive të tyre tu mundsohej punësim adekuat. Puna është ajo që e mban individin apo edhe tërë shoqërinë, pa punë nuk arrihet asgjë dhe jorastësisht mungesa e gjërave elementare si rezultat i skamjes apo papunësisë e çonë individin në veprime ekstreme.

Shteti respektivisht institucionet shtetërore kanë obligim që qytetarëve tu ofrojnë mirëqenie dhe siguri, dhe në këtë drejtim patjetër duhet të ndërmarrin masa adekuate dhe efikase në zgjidhjen e kësaj problematike. Dënueshmëria me ligj përkatësisht kod penal të veprimeve të cilat në vete ngërthejnë ekstremizëm të dhunshëm ka ndikim mirëpo nuk duhet të lihet si formë e vetme e parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie. Dënimi me burgim nuk është çdoherë efikas,bashkëpunimi i ndërsjelltë dhe korrekt ndërmjet institucione shtetërore dhe qytetarëve të thjeshtë, do të shpiente një gjetjen e një zgjidhjeje adekuate dhe të pranueshme për të gjithë, dhe kështu shoqëria do të aftësohej në prandailmin dhe luftimin e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm.

5.2. Mekanizmat të cilat i ka paraparë Bashkësia fetare islame e Maqedonisë

Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, islamit respektivisht muslimanëve ju vesh diçka që aspak ska të bëjë me ta. Që prej asaj kohe në çdo vend të botës pasi ndodh ndonjë sulm në vende publike, fillimisht pritet të mësohet për përkatësin religjioze të sulmuesit apo sulmuesve dhe më pas cilësohet sulmi i tillë. Shumicën e rasteve vetëm se deklarativisht apo bazuar në prejardhjen dhe emërtimin e sulmuesit/ve llogaritet si musliman, menjëher sulmi cilësohet si terrorist me prapavijë të ekstremizmit të dhunshëm apo thënë ndryshe si terrorizëm islamik dhe e kundërta në qoftë se sulmin e kryen ndonjë individ apo grup që i përket ndonjë religjioni tjetër, atëher nuk cilësohet si sulm terrorist me prapavijë religjioze por vetëm si vepër e rëndë terroriste.

Ndërlidhjen e islamit me vepra terroriste mund ta bëjë vetëm një laik i cili nuk ka asnjë dijeni për këtë mësim-besim. Ajo çka na mëson Islami nëpërmjet librit të shejntë të shpallur nga Zoti, Kur'an-it është krejtësisht në kundërshtimi me atë që veprojnë individ apo grupacione të cilët vetëm deklarativisht shprehen se i përkasin këtij besimi, e gjithë kjo e argumentuar me fakte. Në suren Bekare, ajeti 256 thuhet „në fe nuk ka dhunë”⁹¹, poashtu në suren el-Maide ajeti 32 thuhet: „ai i cili vret një njeri të pafajshëm konsiderohet sikur ta ketë vrarë tërë njerëzimin”⁹², edhe shumë ajete të tjera na flasin për këtë çështje. E rëndësishme është që të kuptojmë se një musliman i vërtet bazohet në burimet kryesore të fesë dhe nuk kryen veprime të cilat janë në kundërshtim me ato rregulla. Akuza direkte kundër islamit për veprimet të cilat i kryen një individ apo grupacion që deklarativisht i përkasin këtij religjioni është absolutisht i papranueshëm dhe i pa bazë. Ajo që e dallon një musliman të vertet nga ai deklarativisht që paraqitet si i tillë është vepra. Shumica e sulmeve terroriste të cilat janë cilësuar si sulme nga radikalët islamik, janë kryer nga njerëz të cilët kanë vetëm emër muslimani asgjë tjetër, pasi nga hulumtimet e mëvonshme është zbuluar edhe nga vetë familjarët e tyre është vërtetuar se ato kanë zhvilluar një jetë të shfrenuar, duke pirë alkool, drogë ose substanca tjera të cilat ta humbin vetëdijen, të gjitha këto të ndaluara sipas fesë islame.⁹³

Sa janë të aftë muslimanët për tu mbrojtur nga këto akuza në adresë të tyre dhe çfarë masash marrin institucionet kompetente fetare për ti mbrojtur ato është çështje diskutabile. Bazuar në ngjarjet të cilat kanë ndodhur deri tani, për shumë arsye muslimanët nuk janë treguar të aftë që të mbrohen nga këto sulme. Paaftësia e tyre ndërlidhet me një sërë faktorësh duke filluar nga institucioni më përgjegjës për gjendjen e besimtarëve e deri te besimtarët e thjeshtë. Bashkësia islame e R.M.-së deri më tani nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret në realizmin e ndonjë strategjie për mbrojtjen e besimtarëve nga dukuria e ekstremizmit të dhunshëm kryesisht me pretekst religjioz. Çka është bërë në këtë drejtim mund të theksohet vetem paraqitja publike e

⁹¹ Suretul el Bekare, ajeti, 256, Kur'an

⁹² Suretul el Maide, ajeti, 32, Kur'an

⁹³ <http://www.express.co.uk/news/world/693421/Terror-attacks-timeline-France-Brussels-Europe-ISIS-killings-Germany-dates-terrorism>, publikuar më 17.gusht.2017, i qasshëm më 20.tetor.2017

reis ulema Sulejman ef. Rexhepi kreut të BFI-së me çka ai dënon dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm dhe bën apel për të mos shkuar në zonat e krizës respektivisht Siri, Irak apo kudo tjetër ku mendohet se zhvillohet kjo dukuri negative. Në këtë drejtim vlen të theksohet edhe qëndrimi i reis ulemas, lidhur me atë se të gjithë ato persona të cilët kthehen nga vende në të cilat zhvillohet dukuria e ekstremizmit të dhunshëm nuk duhet të dënohen me burgim, por duhet të gjindet një tretman adekuat për trajtimin e tyre në bashkëpunim me të gjitha institucionet kompetente relevante për këtë çështje.⁹⁴

Duke u bazuar në kapacitetet reale të cilat i disponon Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë ka mundur të bëjë shumë më shumë në drejtim të parandalimit, përballjes dhe mbrojtjes së besimtarëve nga dukuria e ekstremizmit të dhunshëm. Më e pakta që mund të kishte bërë është si p.sh. shpërndarja e fletushkave me përmbajtje elementare dhe të nevojshme për tu mbrojtur nga ekstremizmi i dhunshëm edhe atë në disa gjuhë si shqip, maqedonisht dhe anglisht, organizimi i të gjitha strukturave përbënda institucionit fetar dhe dalja publike me fetva për këtë çështje, kontrolli i plotë mbi të gjitha xhamitë në territorin e R.M.-së, udhëzimi i muftinive dhe më pas udhëzimi nga ana e tyre imamëve për të zhvilluar ligjërata efikase për sqarimin e së vertetës në lidhje me këtë dukuri, organizimin e debateve publike për trajtimin e kësaj çështje, organizimin e tubimeve publike për të sqaruar efektet e kësaj dukurie, argumentimin se kjo dukuri nuk ndërlidhet aspak me fenë islame dhe shumë mënyrë tjera për të mbrojtur besimtarët në veçanti dhe tërë shoqërinë në përgjithësi. Mungesa e vullnetit, qasja me seriozitet jo aq të madh kësaj çështje, transparenca joadekuate, mungesa e kontrollit ndaj këtij institucioni dhe institucioneve të tjera fetare mund të jenë shkaqe për mos angazhimin e tyre në shumë sfera të cilat tangojnë interesat e shoqërisë në përgjithësi.

Sot në R.M.-së në të gjitha institucionet fetare ekziston një kaos i vërtet që lirisht mund të thuhet se në këto institucione është instaluar një diktaturë. Kreu i institucionit kontrollon gjithçka pa mos i dhënë llogari askujt për veprimet e veta dhe çdokush që i kundërvihet vendimeve të tij pëson pasoja të ndryshme, e gjithë kjo bazuar në të drejtën ekskluzive të tyre për të qenë udheheqës deri sa të jenë të gjallë apo përjetësisht. Këto të drejta të tyre të fituara jo sipas bindjes së qytetarëve të komunitetit që përfaqësojnë, por sipas mënyrës së tyre të organizimit brenda për brenda institucionit shpije në një komoditet të tyre dhe neglizhim të interesave të komuniteteve. Kontrolli ndaj këtyre institucioneve nëpërmjet një mekanizmi të krijuar nga vetë komunitet do të ishte zgjidhje adekuate dhe shtytje e tyre për tu marrë seriozisht me problemet dhe hallet e njerëzve që i përfaqësojnë dhe me kontributin e të cilëve ato ekzistojnë.

⁹⁴ <http://bfi.mk/al/ef-rexhepi-shoqerive-tona-i-duhet-ndergjegjesimi-publik-rreth-islamit/>, publikuar më 21.maj.2015, i qasshëm më 20.tetor.2017, <http://tesheshi.com/kreu-i-bfi-se-sulejman-ef-rexhepi-nuk-jam-vehabist-te-ikurit-ne-siri-duhet-te-kthehet/>, publikuar më 4.shkurt.2016, i qasshëm më 20.tetor.2017

5.2.1. Intervista me prof.dr. Musa Musai⁹⁵

1.Biografia?

1.Musa Musai, i lindur në vitin 1970 në Gradec të Gostivarit, shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Medresen Isa Beu në Shkup prej vitit 1984-1988, pastaj tre vite studimi në Universitetin e Sarajevës në fakultetin e studimeve Islame, në vitin 1992 për shkak të situatës së krijuar në Bosnjë e Hercegovinë, ndërpres studimet shkaku i luftës, ndërkohë gjithnjë interesim për të vazhduar studimet në ndonjë vend tjetër. Fati im do kishit thënë pas një qëndrimi të shkurtër në Kajro të Egjiptit, transferohem në Stamboll në vitin 1993 dhe në këtë mënyrë bëj transfer të studimeve të mia bazë të filluara në Sarajevë, por kur kaloni prej një sistemi në një sistem tjetër atëherë kishte disa dallime në sistemin e arsimit. Këtu tek ne ishte me vite, 4 (katër vite) kurse në Stamboll nëpër Universitete kishin bërë ato reformat e kredive, ishin 8 semestra kështu që unë u detyrova të fillojë vitin e dytë edhe të tretin, të dy bashkë ti kryej. Në vitin 1996 kam diplomuar, pas diplomimit kam vazhduar në Universitetin Marmara, në drejtimin e psikologjisë së religjionit. Në vitin 1998 kam magjistruar, tema e magjistraturës ka qenë „Perceptimi i identitetit kombëtar dhe fetar te shqiptarët në Maqedoni dhe Turqi”. Ky hulumtim tani më është i botuar nga shtëpia botuese „Logos-A”, ndërsa pas një viti pauze vazhdova me doktoraturën për drejtimin e caktuar Psikologjia e religjionit dhe në vitin 2004 kam doktoruar. Punimi i doktoraturës ka qenë „Integrimi i identitetit-fesë tek muslimanët e Ballkanit”. Ka qenë një punim që ka hulumtuar shtresimet identitare të shqiptarëve, torbeshëve, boshnjakëve dhe turqëve. Ka qenë një studim krahasues sa i përket identitetit social dhe qëndrimeve religjioze. Në vitin 2005 kam filluar të ligjeroj në Universitetin Ndërkombëtar në Novi Pazar. Në vitin akademik 2009-2010 kam filluar të ligjeroj në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në katedrën e psikologjisë, ku akoma jam i angazhuar. Thirja mësimore profesorë inordinar.

2.A mendoni se termet ekstremizëm, radikalizëm, dhunë dhe terrorizëm kanë bazë fetare?

2.Musa Musai: Nëse e analizojmë prizmin e nocioneve të përmendura, përpos terrorizmit, ekstremizëm, dhunë dhe radikalizëm kemi edhe në ideologjitë tjera dmth nuk është kusht që një ekstremist apo një person i dhunshëm ose edhe terrorizmi në situata të caktuara mund ta kemi me motive të ndryshme. Mund të jetë me motive etnike, mund të jetë me motive sociale, mund të jetë me motive kushtimishtë thënë me motive gjuhësore ose racore. Sepse ne e njohim një sistem që ka pasur ekspansionizmin ose kushtimisht ne atë e llogaritim si një llojë mbikqyrje ose qëndrim sipër një populli tjetër në kuptimin e kësaj, për atë arsye vetëm si nocione nëse analizojmë etimologjikisht, këto terme nuk janë direkt të ndërlidhura me konceptet fetare, pavarësisht se 11 shtatori i 2001 ka imponuar që terrorizmi të identifikohet me motiv fetar, për shkak të ngjarjes edhe për shkak të themi të kaosit që krijoi një rast i tillë. Andaj për mendimin

⁹⁵ Intervista me prof.dr.Musa Musai, realizuar më 14.10.2017

tim personal këto terme në esencë nuk asocojnë dmth me automatizëm kur e përmend nuk do të thotë se këto asocojnë në çështje të cilat kanë të bëjnë me konceptet fetare ose me prapvijë fetare. Fundja nëse marrin ti ndajmë ideologjitë atëherë radikalizmin e kemi si koncept politik më shumë, cilën do variant ta analizoni në vijën e ideologjive, qoftë nacionalizmin, qoftë konceptet tradicionale supozojmë në kuadër të të djathtës, në SHBA janë republikanët, në britani janë konservativët në sistemin gjerman është CDU edhe në kuadër të këtyre organizimeve politike ekziston mundësia që në situata të caktuara kemi një lloj radikalizmi me tendencë politike. Ngjarja e fundit për mendimin tim është paraqitje e pegidës në gjermani, është një ngjarje ose një fenomen i cili bënë me dije se brenda veprimit politik ka edhe tendenca të perfaqësimeve ekstremiste të dhunshme, deri më tani nuk kemi ndonjë ndërlidhje terroriste sa i përket kësaj, mirëpo veprime ekstremiste të dhunshme dhe radikale kemi dhe mund t'i vërejm. Përmenda, ndoshta arsye se këto katër terme janë të ndërlidhura me koncepte fetare është më tepër ngjarja e 11 shtatorit në SHBA duke u bazuar nga pikëpamja se si unë i shoh ngjarjet.

3.Cilët faktorë ndikojnë në Ekstremizmin e dhunshëm,sipas jush?

3.Musa Musai: Faktorët e ekstremizmave të dhunshëm mund të vijnë edhe si rezultat i pakënaqesive sociale, politikave shtetërore që një vend mund ti udhëheq ose kryesoj. Nëse ndalemi të analizojmë, më ka pëlqyer shumë konstatimi i Tomas Xhefersonit që tregon një kulturë politike të ngritur apo ku tregon se shoqëria Amerikane është e përgaditur ta kuptoj racionalisht thënien që e ka përdor Xhefersoni, ku thotë:„aty këtu, të kemi rebelim ose kryengritje të shoqërisë për probleme të caktuara sociale është aq e nevojshme sa edhe vet stuhia për natyrën’’. Është e pamundshme ne ta shohim si diçka, mirëpo pse janë të rëndësishme konceptet apo perceptimet e njerëzve te kjo thënie, nëse këtë thënie ne nuk tregojmë se e ka thënë Tomas Xhefersoni, sa është e mundshme që dikë që i njeh proceset politike ose veprimet e caktuara dhe organizimet e caktuara shtetërore të ja dedikoj të njejtën thënie Vladimir Iliç Leninit, është e pamundshme sepse në konceptet e socializmit që u kriju si ideologji, një veprim i këtillë llogaritet kryengritje kundër shtetit dhe është e dënueshme me ligj. Dua të them se ndonjëher socializimi politik i një vendi është përcaktuesi final i asaj se si do të kuptohet në këtë rast ekstremizmi i dhunshëm. Për mua a mund ta mohoj dikush, themi protestat në Francë për çështjen e reduktimit të orarit të punëtorit brenda javës, atë e nisën shoferët e kamionëve, pastaj bujqit, pastaj një sërë protestash të cilat në vete bartnin edhe një lloje dhune sepse atje mund të shiheshin pamje të caktuara ekstreme, sepse nuk bëheshin kërkesat me lule, por bëheshin ose duke thyer diçka kryesisht pronë publike dhe private dhe njerëzit për ta reflektuar ndonjëherë pakënaqësinë e tyre në lidhje me një sistem të caktuar, ekzisotn mundësia që të shfaqin një qendrim ekstrem të shprehur me dhunë. Prandaj nëse ndërlidhim ekstremizmin e dhunshëm edhe nga këndvështrimi fetar, definitivisht ne nuk mund ta mohojmë se ka tendenca të caktuara me motive të këtilla, ne nuk mund ta mohojmë ekzistimin e një ISIS ose nuk mund ti mohojmë situatat e krijuara në Irak, në Siri në Afganistan, këta janë dëshmi të ekstremizmave të dhunshme që kanë një lloj motivi ose nxitjeje ose kushtimisht thënë një lloj nxitësi fetar. Në këtë drejtim

pikëpamjet ideologjike kanë një rol të vaçant. Është shumë e rëndësishme burimi, mënyra e interpretimit të një koncepti fetar i cili është respektivisht kush i bën dhe kjo nuk varet nga burimi esencial i feve por varet nga interpretuesit që e bëjnë një normë të caktuar, sepse një fe e cila promovon paqen të ja ndërlihdhish krejt këto komponenta negative, duke u marrë me çështje parciale, me ligjërata diskutime, interpretime të njerëzve që i bëjnë një koncepti të caktuar fetar. Arsye ose shkak i polarizimit të skajshëm të situatave nuk do të thotë që është feja, por është interpretuesi i asaj feje ose ai që bartë një identitet fetar në këto raste. Pra, mund të konkludojmë që sipas mendimit tim faktorë që ndikojnë në ekstremizmin e dhunshëm mund të jenë të ndryshëm duke filluar nga ai social-ekonomik, mënyra e interpretimit të feve, mënyra e organizimit shtetëror respektivisht ushtrimit të pushtetit dhe të gjitha ato që i cekam më lart.

4. Mosha karakteristike e personave të radikalizuar respektivisht mosha në të cilën mund të ndikohet më shumë në këtë drejtim?

4. Musa Musai: Nëse flasim për proceset e socializimit politik dmth të mësuarit, të jetuarit me politikën, atëherë në këto rrethana të qëndrimit në skaj nuk i hasim shumë te grupmoshat e pjekura, të themi rrallë herë kemi situatë ku mbas moshësh dyzetvjeçare dikush të jetë ose të bëhet ithtar apo protagonist i një veprimi të caktuar me ideologji dhe me tendencë ekstreme ose radikale. Por cilët janë më të përshtatshme? Më të përshtatshme janë ato kur fillon procesi i edukimit, nëse juve e merni një grup të rinjsh, e keni shumë lehtë, sepse backgroundi i atyre është shumë i dobët, të themi është i varfër ma drejtë apo siç thotë Xhon Luki „një tabollarasë“ asgjë skan të shënuar mbrenda asaj dhe ju mund të regjistroni ose të bartni çdo variant radikal dhe për ata të duket e akceptuar, sepse fundja nëse e përdorni radikalizmin fetar mund të shkoni në variantin që ty të pret parajsa, bëne një akt të këtillë dhe e përfundon misionin. Në anën tjetër nëse i riu ose e reja që bije pre e kësaj, jetojnë në rrethana sociale të kufizuara, të vështira kjo edhe më shumë e mundëson si lloj pakënaqesie, revolte ndaj asaj shoqërie sepse mos harrojmë edhe faktorët psikologjik në adoleshencë që ne e mësojmë, idealizmin e skajshëm. Adoleshenti ka prirje për të rregulluar gjërat përnjëherë dhe ju nëse i thoni se kësaj bote i bëhet padrejtësi, ekziston mundësia çdokush të tregoj një tendencë ose një gatishmëri për të ju vënë në shërbim të një ideje ose ideologjie të radikalizuar, plus asaj se kjo pse e themi se moshat e reja janë më të rrezikuara, psikologët shquhen me eksperimente, tregojnë se si eksperimentohet në këto raste. Xhon Bi Wadson thotë: më jepni një të zi, një grup fëmijësh ose të rinjsh edhe më tregoni çka doni ti bëj unë ata, vrasës, tregtar, ekonomist, jurist krejt i bëj. Kjo tregon se truri i të riut i adoleshentit është shumë i prirur dhe i gatshëm që të mund të manipulohet ose manovrohet me të.

5. Cfarë metodash psikologjike mendoni se përdorin rekrutuesit për të rekrutuar sa më shumë njerëz?

5. Musa Musai: Besoj se ekzistojnë shumë mënyra për të rekrutuar njerëz, ndër të cilat: premtimet, idealizimet e skajshme për një lumturi të përjetshme si metod, shpërblime të caktuara të cilat kryesisht orientohen drejt jetës së amshueshme, parajsës. Por pse jo edhe taktikat psikologjike dmth duke shfrytëzuar dhe duke njohur nivelin e zhvillimit mendor ose intelektual të një njeriu, ju shumë lehtë e keni nëse i njihni karakteristikat psiko-sociale. Erik Eriksoni këtu është shumë i shquar, ai flet për krizë identiteti për adoleshentët dhe atje shumë lehtë e keni për ti orientu në drejtimet ose mënyrat se si mund të manipulohet me ta.

6. Mënyrat e rekrutimit? Nëpërmjet rrjeteve sociale, përmes kontaktit direkt apo përmes predikimit në xhami, kisha ?

6. Musa Musai: Në vendet e zhvilluara mundësia për ti organizuar njerëzit me kontakte direkte është gati se e pamundshme. Atje ku funksionojnë të themi kamerat publike të vendosura gjithandej, është shumë lehtë për ta kontrolluar një veprim grupor të dikujt, ndërsa sa i përket rrjeteve sociale vërtet është vështri sepse ne nuk kemi ndonji çels ose ndonjë filtër që do e përpunoj interpretimin, ligjeratën ose diskutimin e dikujt në lidhje me një çështje të caktuar. Unë nuk mendoj se xhamitë janë objekte ku mund të interpretohet deri në këtë masë ndonjë lloj i radikalizmit fetar, por as që mendoj edhe për kishat mund ta bëjnë të njëjtën. Por nëse flasim për konceptet e kju klus klanit në SHBA që ka qenë ose edhe të tjera të caktuara në periudhën e paragjyqimeve të skajshme ose sindromës etnocentrike, racore atehëre këtu flitet për mënyra dhe variacione publike. Por sot themi këto variacione gati se shtetet në përgjithësi i shmangin, veçmas nëse flasim për kulturën perendimore, nëse flasim për shtetet e Azisë me përjashtim të Burmës, atje kemi një lloj shfaqjeje mllëfi politik deri në masën e asgjësimit të tjetrit me konotacion budist, ato thonë se të motivuar nga pikëpamja budiste, a në fakt ato që e njohin budën e dinë se buda ka aluduar vetëm në ngritje shpirtërore nuk ka pasur tendenca dhune, ja edhe një keq interpretimi i konceptit religjioz. Për atë jam i mendimit se rrjetet sociale janë faktorët kyç për të promovuar jovlera radikale me motive religjioze, por këto nuk do të thotë se duhet të ndërlidhen vetëm me besimin islam. Unë mendoj se kemi koncepte radikale religjioze keni plotë në rrjetet sociale të botës krishtere edhe të rastit që permenda budiste, megjithatë nuk duhet mohuar se më aktualet dhe më në shënjestër janë pjesa e muslimanëve kur përdorin terme dhunë, armatë, armë, luftë edhe kështu me radhë.

7. Përveç ekstremizmit fetar, a mendoni se ekziston edhe ndonjë llojë tjetër i ekstremizmit në R.M.-së, p.sh. ai etnik apo nacional ?

7. Musa Musai: Gjithësesi, në bazë të veprimit politik të strukturave të caktuara, qofshin ato organizata zyrtare të regjistruara ose qofshin ato organizata vetëm ne eterin e digjitalizimit ose rrjeteve sociale. Ne kemi tendenca ose së paku sindroma etnocentrike në maqedoni funksionon. Ku promovohet se vetëm një komb i caktuar ka të drejtën ekskluzive të krijojë politikat në shtet dhe të vendos për fatin e shtetit dhe ku mendohet se vetëm ajo kulturë është e vetmja e kompletuar, të gjitha të tjerat nuk meritojnë të jenë në arenën kombëtare apo shtetërore të këtij vendi ose të këtij populli. Kjo tregon se edhe vet organizimi shtetëror në njëfarë mënyre është ai që e gjenë ose e kërkon fajtorin të një komb ose një grup etnik i caktuar dhe i cili duhet të jetë gjithmonë fajtori kujdestar. Dhe këto janë ato gjërat të cilat mendoj se e ushqejnë përjashtimin nacional të tjetrit apo kur tjetri për ju është vetëm armik, vetëm rival, konkurent është një dozë e rrezikshme e etnocentrizimit ose e sindromës etnocentrike e shfaqur në jetën shoqërore.

8. Ndodhitë në botë, me theks kriza e refugjatëve a ndikon në dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm?

8. Musa Musai: Kriza e refugjatëve ka aktualizuar shumë çështje, për arsye se një pjesë e Evropës në krye me Gjermaninë u paraqitën në të vertet njerëz human, solidar, të interesuar në njëfarë mënyre të zbutin dhimbjen ose vuajtjet që ato i kanë në vendet e tyre, në shtetet e tyre dhe Gjermania shfaq dashamirësi për të pranuar një numër të caktuar të atyre megjithatë ne kemi shumë shtete që janë të Bashkimit Evropian, por të cilët haptas i kanë thënë shqetësimet e tyre lidhur me refugjatët. Rasti më eklatant, më i theksuar i veçantë është Hungaria, e cila i prin procesit të ndjenjës ose ndjesisë së rrezikut potencial nga një fluks refugjatësh dhe veprimi i shtetit hungarez përkon në tendenca për të krijuar mure telash, hermetikisht të jetë i mbyllur një shtet. Është interesante për tu studiuar, cili është burimi i këtillë i irritimit ose përjetimit të rrezikut deri në këtë masë, prej një numri të caktuar personash, shembull 300 ose 3000 persona çka mund të dëmtojnë në Hungari, kur është në pyetje kriza e refugjatëve. Ndoshta kemi qëndrime edhe të shteteve tjera, Sllovenia gati se qëndrim të njejtë apo të përafërt, ndoshta kryeministri Sllovenisë nuk është deklaruar në këtë masë siç u deklarua kryeministri hungarez, por megjithatë këtu tregohet një dozë rezervë dhe për mendimin tim që i vënë në pikëpyetje shumë të madhe vlerat evropiane, të cilat ne gati dy dekada i dëgjojmë se sikur është sistem i përkryer, sikur është parajsë e premtuar për njerëzit, a në fakt kjo tregon se në nënvetëdijen e atyre njerëzve çfarë ka. Kur flasim për nënvetëdijet, ato nuk dinë të fshehin elemente ose motive të caktuara qofshin të urrejtjes ose të frikës apo fobive të caktuara, prej një njeriu që ndoshta nuk e flet gjuhën e tij ose ndoshta pse nuk i takon kulturës së tij edhe kështu me radhë. Prandaj mendoj se disa shtete Evropiane e kanë humb kredibilitetin për të „shitur” vlera morale. Nëse një shtet është i gatshëm

të mbaj referendum për këtë çështje, kjo tregon qëndrim polarizues, të skajshëm, ekstrem mund ta quani apo nëse kjo nuk është ekstremizëm atëherë unë nuk e di si duhet kuptuar ekstremizmi në esencë.

9. Shteti dhe Bashkësia Fetare Islame a kanë bërë sa duhet për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, ekstremizmit të dhunshëm?

9. Musa Musai: Në këtë drejtim mendoj se institucionet kompetente shtetërore fillimisht duhet të punojnë në ngritjen e vetëdijes te popullata lidhur me këtë dukuri negative që ka preokupuar njerëzimin në përgjithësi, poashtu jam i mendimit se duhet ti koridinojnë të gjitha aktivitetet edhe me sektorin civil dhe organet tjera me ndikim në shtet, siç janë në këtë rast bashkësitë fetare. Të krijojnë resurse shtesë në kuptimin e ndihmesës për të parandaluar largimin për të marrë pjesë në luftëra të huaja ose kushtimisht thënë ekstremizimin e individëve të caktuar që kanë dilema, lidhje me punësimin dhe kanë frikë nga ajo se çka ju sjell e ardhmja. Këto dilema është vështirë për ti pastruar, por siç e cekta një bashkëpunim me organizmat shoqëror cilat do qofshin ato. Këtu mund të jetë bashkëpunimi institucional ndërmjet institucioneve fetare dhe institucioneve shtetërore, që të punohet në krijimin e ndonjë strategjie, pse jo edhe të mundësive për të ndikuar tek interpretuesit, që në të shumtën e rasteve janë interpretues jashta institucional. Në Maqedoni nuk ka veprim të individëve të institucionalizuar në organizatat ose në institucionet fetare që do del prej vijës së interpretimit dhe të stimuloj veprime ekstremiste. Megjithatë mendoj se shteti e ka të pamundur të bëjë kontrollin e lëvizjes së të gjithë shtetasve të vet, sepse secili ka lejen e udhëtimit edhe duke u bazuar në linjat të cilat përdoren, pra nuk janë ato direkte Shkup-Damask, por përdoren për shembull Shkup-Stamboll. Në këto raste sa mund të ja ndalosh dikujt që ka të drejtë të udhëtoj në cilin do drejtim apo destinacion që dëshiron. Por me inkorporimin në kodin penal si vepër penale, mendoj se shteti në këtë mënyrë ka treguar fuqinë e vet, në kuptim të asaj se kjo dukuri është negative dhe e ndëshkueshme. Sa i përket BFI-së, mendoj se e ka parë të arsyeshme që përmes deklarimeve edhe qëndrimeve të saja të tregoj për përcaktimin e vet, se definitivisht është kundër mënyrës rekrutuese të njerëzve për dërgim në luftëra dhe këtë e ka thënë disa herë. Por nëse bisedojmë për strategji të mundëshme, nuk mund të themi se ka. Ndonjë strategji konkrete nuk kanë hartuar megjithatë përmes deklarimit të udheheqësit të këtij institucioni kuptojmë qasjen që ky institucion e ka ndaj kësaj dukurie dhe ajo që është mundësuar të vërejmë nga deklarimi është se ato janë kundër ndëshkimit me burg të personave të cilët marrin pjesë në luftëra të huaja, por përkundrazi me ta të punohet më shumë në drejtim të risocializimit dhe riintegritimit në shoqëri sikurse të gjithë individët tjerë. Pra të nëjtit të mos dënohen me burgim, por të angazhohen në punë të ndryshme qofshin ato në dobi të përgjithshme shoqërore dhe në këtë mënyrë ata të ndjejnë veten të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë.

10. Çfarë mendoni ju personalisht, çfarë masash duhet të ndërmeren për parandalimin dhe luftimin më efikas të ekstremizmit të dhunshëm?

10. Musa Musai: Nëse analizojmë platformën e mundshme të masave që mund të ndërmeren për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, nëse flasim për ne, vendin tonë, unë mendoj se këtu shumë shtresave ju bie hise që të kontribojnë. Duke filluar prej OJQ, klubet sportive, shoqatat kulturore, shoqatat ekonomike, organizmat juridik përmes sqarimeve, shtjellimeve, parashikimit të rreziqeve ose të pamundësisë për tu kthyer sërish në vendlindje. Nëse paraprakisht ju e keni informuar dikë, shkuarja juaj në një vend, pjesëmarrja juaj në një luftë me automatizëm ju humb të drejtën e kthimit tuaj ose marrjes së masave dhe dënimit me ligje të caktuara, së paku këto informacione sa i kemi bartur. Për atë arsye them që sektori joqeveritar edhe ata kanë një pjesë të mundshme për të qenë efikas ose së paku për të zvogluar numrin e njerëzve që mund të bëhen, pre e ekstremizmave ose rekrutimeve të mundshme, kjo është çështje me rëndësi. Ndërsa luftimin e ekstremizmit të dhunshëm mund ta bëjnë vetëm institucionet zyrtare, të tjerët janë vetëm në nivelin e sugjerimeve dhënies së informacioneve, stimujve të ndryshëm apo organizimit të eventeve të ndryshme dhe këto mund të jenë faktorët kyq.

5.3. Organizatat joqeveritare, kontributi i tyre në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm

Detyra kryesore e OJQ-ve është ngritja e vetëdijes së qytetareve për çështje të cilat tangojnë interesat e tyre në përgjithësi, duke u përkushtuar në ndonjë sferë konkrete me anë të veprimtarisë së tyre ato dëshirojnë të sensibilizojnë qytetarët për atë problematik që e kanë fushë trajtimi përkatësisht tu ofrojnë njohje dhe të ngrisin vetëdijen e tyre në lidhje me të. Në R.M.-së shumica e OJQ-ve veprimtarinë e tyre kryesisht e ushtrojnë në kryeqytet-Shkup, megjithëse ekzistojnë edhe nëpër vise tjera të territorit të R.M.-së me një numër të reduktuar dhe kryesisht veprojnë organizata joqeveritare që fushë veprimi apo trajtimi kanë sferën e humanizmit.

Sa i përket fushës së sigurisë, që në të bën pjesë edhe ekstremizmi i dhunshëm, gjurmë të veçantë në këtë drejtim ka lënë kontributi i OJQ- Analytica. Organizatë kjo që ka për synim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe ofrimin e zgjidhjes institucionale në drejtim të zhvillimit dhe sundimit të demokracisë në vend dhe në Evropën Jug-Lindore në përgjithësi. Është organizata e vetme e cila merret me hulumtimin e politikave publike dhe emërtohet edhe si „think tank” organizatë me seli në Shkup.⁹⁶ Prej vitit 2001 e këndej Maqedonia ka bërë shumë reforma në sektorin e sigurisë, komplet reformat e sistemit të sigurisë i ka ndjekur OJQ Analytica dhe në këtë drejtim shumë vite radhazi hulumtuesit e saj kanë punuar në tema të sigurisë. Të gjitha reformat në MPB, Ministrinë e Mbrojtjes, shërbimet e intelligence janë ndjekur në mënyrë të veçantë.⁹⁷ Kontributi i kësaj OJQ vihet në pah poashtu edhe me atë një studim të cilën e kanë realizuar hulumtuesit e saj, Kaltrina Selimi dhe Filip Stojkovski me titull „Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, pikëpamje nga shoqëria civile”. Në këtë studim respektivisht në përmbajtjen e tij janë paraparë të gjitha elementet të cilat kanë të bëjnë me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, edhe atë autorët kanë paraparë: definimin e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm, parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, ekstremizmi i dhunshëm me rrënjë në Maqedoni, fenomeni i luftëtarëve të huaj, kundërpërgjigja ligjore dhe institucionale, dimensionin rajonal i çështjes, nevoja e bashkëpunimit rajonal në lidhje me këtë problematik si dhe shumë elemente të cilat sqarojnë dhe ofrojnë zgjidhje për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.⁹⁸ Ekstremizmi i dhunshëm shfaqet si problem ndërkombëtar, andaj ekzistojnë shumë OJQ të cilat fushëveprimi e kanë këtë sferë, ndër të cilat vlen të theksohet: Hedayah, Alliance for peace building, Unesco, Osce dhe shumë të tjera të cilat merren me çështjen e sigurisë në nivel ndërkombëtar.⁹⁹

⁹⁶ <http://www.analyticamk.org/mk/za-nas/misia-i-vizija> , i qasshëm më 24.tetor.2017

⁹⁷ Intervista me Kaltrina Selimi, hulumtuese në OJQ-Analytica, Shkup, realizuar më 20.shtatore.2016

⁹⁸ K.Selimi & F.Stojkovski, Vlersimi i përpjekjeve të maqedonisë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, pikpamje nga shoqëria civile, fq.4

⁹⁹ <http://www.hedayah.ae/> ; <http://www.allianceforpeacebuilding.org/major-ngo-joint-statement-on-counter-ing-violent-extremism/> ; <https://en.unesco.org/news/investing-education-and-young-people-counter-violent-extremism> ; <http://www.osce.org/odihr/25142?download=true> ; të gjitha të qasshme më 01.nëntor.2017

VI. Disa shtete të Ballkanit në raport me dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm dhe rastet në praktik

6.1. Republika e Maqedonisë, raste në praktik të ekstremizmit të dhunshëm

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm rrezikon pothuajse të gjitha shtetet dhe vendet e botës, nuk mund të thuhet lirshëm se ndonjë shtet mund të paraqitet si imun ndaj këtij fenomeni. Në kapitullin paraprak u theksua se çka ka bërë dhe çfarë është dashur të bëjë R.M.,së, në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, këtu ngelet të sqarojmë rastet të cilat kanë ndodhur në praktik dhe të njejtat, çfarë cilësimi kanë marrë edhe pse kanë pasur tipare të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Si rast i cili është etiketuar si ekstremizëm i dhunshëm me prapavijë religjioze është rasti „Celula” i cili është zhvilluar në dy aksione celula1 dhe celula 2 dhe i njëjti ka marrë epilog gjygjësor, poashtu rast i cili ka të gjitha tiparet e terrorizmit të shtytura nga ekstremizmi i dhunshëm kryesisht ai politik. Është rasti i ngjarjeve të 27 prillit 2017 të ndodhura në kuvendin e R.M.-së, rasti akoma nuk ka zgjidhje përfundimtare përkatësisht zbardhja e tij e plotësishme nuk është arritur, edhe pse janë ndërmarrë një sërë veprimesh, ku janë sjellur edhe disa vendime gjygjësore, megjithatë kualifikim adekuat të kësaj vepre dhe përgjegjësi për të gjithë të përfshirurit në të akoma nuk ka.

Rasti Celula është rasti i parë i plasuar në opinion si ekstremizëm i dhunshëm në R.M.së, më 6 gusht 2015 autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm ndërmorrën aksionin Celula, me çrast u arrestuan 9 persona nën dyshimin e organizimit dhe rekrutimit të luftëtarëve për ushtritë e huaja. 27 persona u konsideruan si të pakapshëm për autoritet prej ku për 20 persona u supozua se janë bashkangjitur organizatës ekstremiste ISIS në Siri. Ky aksion ngërtheu në vete një sërë veprimesh, autoritet nga MPB kanë realizuar të gjitha veprimet paratimore dhe më pas në ditën kritike kanë realizuar edhe bastisje në disa qytet si në Kumanov, Shkup, Tetovë, Gostivar dhe Strugë, me çrast janë kontrolluar disa shtëpi private, banesa, OJQ, internet kafe dhe dy xhami.¹⁰⁰ Të gjithë këto persona akuzoheshin për veprën penale të paraparë në KPM neni 322-a pjesëmarrje në formacion të huaj ushtarak, policor, paraushtarak apo parapolicor. Më 9 korrik 2016 MPB filloi operacionin Celula 2 dhe arrestoi 4 persona të dyshuar për pjesëmarrje në organizatat e huaja paraushtarake.¹⁰¹ Këto persona në opinion u cilësuan si ekstremist të dhunshëm me pretekst religjioz të cilët në bazë të aftësive ushtarake të fituara në vendet e krizës në lindje të mesme Siri dhe Irak dhe aplikimit të aftësive të fituara në territorin e R.M.,së do të cenonin sigurinë e saj, por jo vetëm të saj por duke përfshi këtu edhe shtetet e rajonit. Ky rast edhe pse mori epilog gjygjësor, në opinion la

¹⁰⁰ 24vesti. Akcia Kelija (Aksioni Celula) <http://24vesti.mk/policiskata-akcija-%E2%80%9Ekjelija%E2%80%9C-na-mvr-uapseni-9-teroristi-27-se-vo-begstvo> publikuar më 06.gusht.2015, i qasshëm më 11.nëntor.2017

¹⁰¹ Vecer,detail za operacija kelija2 (detaje për operacionin celula2) <http://vecer.mk/makedonija/detali-za-kjelija-2-eve-koi-se-uapsenite-pominale-voeno-teroristichka-obuka-vo-sirija> publikuar më 9.korrik.2016 i qasshëm më 11.nëntor.2017

shumë paqartësi dhe kontradikta e gjithë kjo si rezultat i humbjes së besueshmëris në institucionet shtetërore.

Përpos rastit Celula, rast tjetër ekstremizmi të dhunshëm i ndodhur në praktikë paraqet ngjarja e 27 prillit 2017 në kuvendin e Maqedonisë përkatësisht në shtëpinë e demokracisë. Për shkak të ndikimit të shumë rrethanave ky rast akoma nuk është kualifikuar saktësisht respektivisht të definohet dhe të dihet dhe më pas njoftohet opinioni se çka në realitet ndodhi në këtë datë. Ky rast do të analizohet dhe hulumtohet nga shumë ekspert të lëmisë së sigurisë, jo rastësisht më lartë u theksua si rast i ekstremizmit të dhunshëm pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet për të marrë cilësimin e tillë edhe pse zyrtarisht nuk ka marrë kualifikim të tillë pasi që ato të cilët duhet ta cilësojnë si të tillë vizavi paraqiten si shtytës të kësaj ngjarjeje.

